

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE- SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE



PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA: “Ndikimi i politikës në arsim në Republikën e Maqedonisë së Veriut”

Mentori

Prof.Dr. Agron Rustemi.

Punoi

Furkan Abdullai

Tetovë, 2022

Autorësia

Unë Furkan Abdullai, deklaroj që ky punim është përkushtim i punës sime dhe nuk përmban ndonjë material që është shkruar prej të tjerëve, përveç materialeve të huazuara nga literaturat e autorëve të ndryshëm, të cilët janë cituar nga janë marrë sipas standardeve ndërkombëtare të referencimit dhe nuk përmban plagjiaturë. Gjithashtu deklaroj që pjesa e hulumtimit, është rezultat i punës sime dhe deklaroj që ky hulumtim nuk është prezantuar apo publikuar më parë.

Përmbajtja e punimit

I. Kapitulli I –Hyrje në punim.....	5
i. Lënda e Hulumtimit.....	5
ii. Qëllimet e hulumtimit	5
iii. Hipotezat e punimit.....	6
iv. Metodologjia e hulumtimit.....	7
II. Kapitulli II – Arsimi në RMV dhe sfidat me të cilat është ballafaquar që nga pavarësia e vendit.....	8
1. Sistemi arsimor në RMV	8
2. Strategjia e arsimit në RMV.....	15
3. Sfidat e arsimit në RMV.....	16
3. Ndikimi i politikës në arsim në RMV.....	22
III. Kapitulli III – Analiza statistikore e indikatorëve kryesorë të arsimit në vend.....	28
3.1. Analiza statistikore në nivel republikan.....	28
3.1.1. Shkollimi fillor	28
3.1.2. Shkollimi i mesëm	32
3.2. Analiza statistikore në nivel lokal – Komuna e Gostivarit	37
IV. Kapitulli IV – Shpalosja e rezultateve nga intervistat dhe anketa e realizuar me qytetarë në rajonin e Gostivarit.....	40
Konkluzat.....	58
Rekomandimet.....	60
Bibliografia.....	62

ABSTRAKTI

Ngjarjet dhe zhvillimet politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjatë viteve të pluralizmit politik kanë ndikuar në shumë aspekte të jetës shoqërore në vend, e në veçanti në sferën e arsimit, e cila është njëra nga pikat më të rëndësishme të zhvillimit të një shoqërie bashkëkohore.

Ngjarjet e ndryshme politike, konfrontimet pozitive – opozitive, vështirësitë dhe sfidat nëpër të cilat kalon shteti janë të një interesi të veçantë për të gjithë hulumtuesit, e në veçanti për ata vendorë, ku nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve historike, argumenteve reale e politike do të shqyrtohen, analizohen dhe do të shërbejnë për nxjerrjen e argumenteve dhe konkluzioneve në lidhje me temën në fjalë.

Me metoda analitike dhe me teknikat ndihmëse të hulumtimit, siç janë anketa dhe intervista do të hulumtohen ngjarjet më të rëndësishme politike në vend, duke e krahasuar në të njëjtën kohë edhe reformat në arsim dhe impaktin e politikës në këtë dikaster. Rezultatet do të evidentohen dhe elaborohen duke na dhënë statistika të mirëfillta në lidhje me temën e elaboruar.

KAPITULLI I – HYRJE NË PUNIM

1. Lëndë e hulumtimit

Rëndësia e këtij punimi është e vecantë dhe e ndjeshme pasi që pluralizmi politik nuk e pati atë transformim politik të cilët e pritën qytetarët. E njëjta nuk i dha efektet e duhura në sferën e arsimit, gjë e cila mund edhe të konkludohet duke bërë poashtu krahasim edhe me vende të tjera të dalura nga sistemi monist në Evropën lindore, vende të cilat patën ecuri më të suksesshme politike dhe arsimore të ndikuar nga faktorë të ndryshëm.

Ngjarjet dhe zhvillimet politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjatë viteve të pluralizmit politik kanë ndikuar në shumë aspekte të jetës shoqërore në vend, e në veçanti në sferën e arsimit, e cila është njëra nga pikat më të rëndësishme të zhvillimit të një shoqërie bashkëkohore.

Rëndësia e këtij punimi është e vecantë dhe e ndjeshme pasi që pluralizmi politik nuk e pati atë transformim politik të cilët e pritën qytetarët. E njëjta nuk i dha efektet e duhura në sferën e arsimit. Në këtë punim do të përmenden pos të tjerash edhe mundësitë për përfundimin e tranzicionit të zgjatur dhe aspektin integruar të shtetit.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet e këtij hulumtimi do të jenë analiza e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve në veprimtarinë e tyre në fushën politike dhe arsimore por edhe të një vizioni real praktik për një të ardhme të mirë të shtetit mbi bazë të ndikimeve dhe vendimeve të brendshme që do të reflektonin në reforma të mirëfillta në sferën e arsimit, është të kontribuojë në promovimin e arsimit përfshirës dhe politikave dhe praktikave trajnuese në kontekst të diversitetit social dhe kulturor të Ballkanit Perëndimor.

Nëpërmjet hulumtimit do të bëj nxitje që rezultatet nga tranzicioni politik, e në veçanti në sferën e arsimit në shtet të elaborohen dhe të shihet gjendja FAKTIKE dhe e njejta të dokumentohet.

3. Hipotezat

Dizajni i hulumtimit vjen nga konceptet kryesore të përshkruara më lartë dhe presupozimet e adaptuara për këtë studim, duke u bazuar në ekzaminimin ekstenziv të literaturës. Më poshtë i përshkruajmë hipotezat mbi të cilat është bazuar ky hulumtim ku ato janë eksploruar në këtë studim.

- 1. Hipoteza e veçantë-** Lufta e brendëshme për pushtet ka ndikuar negativisht në procesin arsimor në përgjithësi, dhe në procesin e reformimit të këtij dikasteri në veçanti.

- 2. Hipoteza gjenerale** Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në strukturat euro-atlantike do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së arsimit, duke pasur parasysh harmonizimin e legjislatujrës me atë të Bashkimit Evropian.

4. Metodologjia e punimit

Për të realizuar një punim të këtillë duhen përpunuar një numër të madh informacionesh e duhet bërë krahasimi dhe me pas analizimi i literatures së autorëve të ndryshëm vendor dhe të huaj, me qëllim që punimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe më i suksesshëm.

Hulumtimin tonë më të gjerë për ndikimi e politikës në arsim në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilën ishin kyçur 110 personave me karakteristika të ndryshme demografike si dhe profilin profesional , parashtrova edhe gjashtëmbëdhjetë pyetje për ndikimin e politikës mbi arsimin, përshkak të kompleksitetit të temës, pyetjet ishin në llojë të mbyllur ku të anketuarit mund të zgjidhnin nga alternativat e ofruara, për këtë arsye do të përdoren teknika ndihmëse siç janë:

1. historike – përshkruese,
2. komparative
3. analiza e dokumentacionit
4. anketat dhe intervistat

Duke i përdorur këto metoda do të sigurohet mundësia për përpunimin e punimit në baza shkencore. Paraqitjen e të dhënave në vazhdimë të hulumtimit do të na qojnë në një rezultatë mjaftë kompleksë dhe me shumë informacione të reja e interesante për mesin dhe shoqërinë tonë duke paraqitur gjithashtu edhe një pasqyrë realiteti në shtetin tonë.

KAPITULLI II - ARSIMI NË RMV DHE SFIDAT ME TË CILAT ËSHTË BALLAFAQUAR QË NGA PAVARËSIA E VENDIT

1. SISTEMI ARSIMOR NË RMV

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut pasqyron nevojat e shoqërisë për rol arsimor, shkencor dhe të përhershëm të arsimit dhe shkencës për zhvillimin ekonomik, social, teknologjik dhe kulturor të shoqërisë në tërësi. Sistemi arsimor i Maqedonisë është i decentralizuar. Menaxhmenti i shkollave fillore dhe të mesme është nën përgjegjësinë e komunave, me përjashtim të shkollave të mesme në kryeqytetin Shkup të cilat janë nën përgjegjësinë e Qytetit të Shkupit. Shteti siguron burime financiare për arsimin për komunat në formën e bllok dotacioneve. Ato komuna që janë ende në fazën e parë të decentralizimit marrin bllok dotacione për financimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës, ndërsa për pjesën e pagave të personelit nëpër shkolla ato ende janë të shpërndara në mënyrë qendrore. Komunat që janë në fazën e dytë të decentralizimit marrin bllok dotacione si për infrastrukturën ashtu edhe për pagat e punonjësve të shkollave. Këshillat e komunave janë plotësisht përgjegjëse për shpërndarjen e brendshme të burimeve financiare nga bllok dotacionet ndërmjet shkollave që janë në përgjegjësinë e tyre. Menaxhimi i të gjitha shkollave për nxënësit me nevoja të veçanta është nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës¹.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë përcakton të drejtën për arsim për të gjithë nën kushte të barabarta. Aq më tepër, Kushtetuta specifikon se arsimi fillor dhe i mesëm është i detyrueshëm dhe pa pagesë. Në mënyrë të detajuar, këto dispozita përcaktohen nga Ligjet specifike, siç është Ligji për Arsimin Fillor, Ligji mbi Arsimin e Mesëm dhe Ligji mbi Arsimin Tërciar (e lartë). Këto të drejta dhe obligime të ndërmara me Kushtetutë ndërsa ligjet specifike implikojnë strategji dhe politika nga ministria e sektorit (Ministria e Arsimit) që duhet të reflektojnë ndaj diversitetit në shoqëritë tona.

Sipas Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Ministria e Arsimit të Republikës së Maqedonisë i kushton vëmendje të posaçme elementit të përfshirjes sociale në sistemin

¹ https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/former-yugoslav-republic-macedonia_en

arsimor me qellim qe te krijohet nje system perfshires, I hapur per te gjithë segmented e shoqerise. Per shembull, Programi per Zhvillimin e Arsimit (2005-2015) I pergatitur nga Ministria e Arsimit, I kushton vemendje te posacme mirekuptimit nderetnik sim jet per nje shoqeri dhe me perfshirese. Aq me teper programi I njejte ben thirrje per vendosjen e mekanizmave per detektimin e femijeve te cilet ndodhen jashte institucioneve arsimore me qellim te ferfhsirjes se tyre ose kthimin ne sitemin arsimor.

Programi definon grupet e rrezikuara (vulnerable) si “femije nga rajone te pazhvilluara, femije me pengesa mesimi, femije qe perparojne ngadale, femije nga familje disfunksionale, femije me semundje kronike qe ndikojne vajtjen e tyre te regullt dhe mundesite per delirje ne procesin e mesimint, femiije me gjuhe amtare ndryshe nga gjuha e institucionve ne shkolle”.

Sipas qeverise, nje theks I posacem I eshte dhene arsimimit te populates rome. Ne kete menyre qeveria eshte e prire ta nxjere ne pah rolin e Byrose per Zhvillimin e Arsimit qe ben perpjekje, perms projekteve te caktuara (p.sh Dekada e romeve “Arsim per cesilin” , nen kujdesin e UNESCO-s) , per te ngritur numrin e studenteve ne arsimin e mesem (vecanerisht atyre te populates rome dhe nga zonat rurale).

Lidhur me kete, nen Strategjine rome dhe Dekaden, Ministria e Arsimit dhe Shkences inkurajon bashkepunimin midis sektorit te OJQ-ve dhe populates rome me qellim qe te ngrihet vetedija per arsimin dhe perfshirjes se romeve ne procesin e perfundimit te arsimit, Brenda kornizes se sistemit per arsimin e te rriturve.

Edhe perkunder perpjekjeve te qeverise edhe ne krijimin e politikës dhe ne sferen e zbatimit te politikës eshte e dukshme nga analizat e te dhenave te organizatave nderkombetare dhe OSHC se me teper duhet te behet ne menyre qe te prodhohet nje system qeverises I cili do te jete “miqesor” per grupet vulnerable ne shoqerine tone.²

Arsimi dhe perdorimi I gjuheve mund te perceptohet si nje element i rendesishem per te nxjerre politika me kumptimplota qe reflektojne karakterin shumetnik dhe shumegjuhesor te Republikes se Maqedonise se Veriut. Marrëveshja verteton te drejten e nxenesve ne arsimin fillor dhe te mesem qe te arsimohen ne gjuhen e tyre amtare brenda sistemit te Republikes se

² Metodologjia e vleresimit te qeverisjes dhe ndikimi i saj ne perfshirjen sociale ne sektoret e arsimit dhe shendetesisë ne Republiken e Maqedonisë, 2011

Maqedonise se Veriut. Ne nivelim terciar, Qeveria e ka pergjegjesi qe te siguroje fonde shteterore per studentet gjuha e te cileve flitet ng ate pakten 20% e popullates se Republikes se Maqedonise se Veriut. Vec kesaj, percakton kerkesa per Universitetet shteterore qe te zbatojne politika te diskriminimit pozitiv (veprim pozitiv) me qellim qe popullsia studentore te pasqyroj diversitetin ne Republiken e Maqedonise se Veriut.

Procesi arsimor

Arsimi në RMV është i detyrueshëm nga mosha gjashtë deri në 19 vjeç për arsimin e mesëm të përgjithshëm, ose nga gjashtë deri në 17, 18 ose 19 vjeç për arsimin dhe aftësimin profesional, në varësi të drejtimit të përzgjedhur profesional.

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga tre nënsisteme:


1. Arsimi fillor: në kohëzgjatje nëntë vjeçare, i njëjti është falas dhe i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës 6 deri në 15 vjeç, pa marrë parasysh gjininë, fenë dhe kombësinë. Veprimtaritë e arsimit fillor janë të përcaktuara dhe të rregulluara me Ligjin për arsimin fillor dhe me konceptin për arsimin fillor nëntëvjeçar. Misioni i këtij nënsistemi është të rrisë, edukojë dhe udhëheqë. Në tri klasat e para vlerësimi i nxënësve është përshkrues, kurse për klasat e tjera është numerik (nota 1 deri në 5).

2. Arsimi i mesëm: arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnazi) në kohëzgjatje katërvjeçare dhe arsimi profesional (shkollat profesionale) në kohëzgjatje dy (arsimi profesional dyvjeçar), tre (arsimi profesional për profesione) ose katër vjet (arsimi teknik profesional). Arsimi i mesëm është i detyrueshëm dhe përfshin të gjithë fëmijët e grupmoshës 15 deri në 19 vjeç për arsimin e mesëm të përgjithshëm, dhe për grupmoshën 15 deri në 17, 18 ose 19 vjeç në atë teknik në varësi të drejtimit të zgjedhur. Veprimtaritë dhe përgjegjësitë e arsimit të mesëm janë të përcaktuara dhe të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Mesëm dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Arsimi i mesëm është pa pagesë në shkollat e mesme publike.

3. Arsimi sipëror: realizon studime universitare, master dhe doktoraturë në institucionet dhe institutet e arsimit të lartë të pavarur. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë shtatë universitete shtetërore dhe 14 universitete private. Veprimtaritë janë të përcaktuara dhe të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Lartë.

Se si duket strukturat e sistemit arsimor, me së miri e tregon figura e mëposhtme:

Figura 1 – Struktura e sistemit arsimor në RMV



Burimi: Strategjia e Arsimit dhe plani i veprimit

Institucionet që menaxhojnë me procesin arsimor

Ministria e Arsimit dhe Shkencës është institucioni kryesor që menaxhon me sistemin arsimor në vend. Por përveç asaj ka edhe disa institucione të tjera të cilat ndihmojnë procesin e arsimit në vend. Njëra ndër to është Biroja për Zhvillimin e Arsimit.

Byroja për Zhvillimin e Arsimit

Byroja funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit, dhe është përgjegjëse për zhvillimin dhe përparimin e edukimit dhe arsimin në vend. Byroja në kuadër të punës së saj bën ndjekjen, kontroll profesional, hulumtim, përparim dhe zhvillim të procesin edukativo-arsimor të të gjitha nivelet e arsimit duket filluar nga arsimi parashkollo, atë fillor, të mesëm, atë profesional, arsimin për fëmijëve me nevoja të ndryshme dhe arsimin e të rriturve. Ajo poashtu është përgjegjës për arsimin e fëmijëve të qytetarëve që janë jashtë vendit. Në kuadër të Byrojës funksionojnë katër sektorë dhe atë si vijon:

- Sektori për planet dhe programet mësimore
- Sektori për kërkime në arsim
- Sektori për zhvillim profesional
- Sektori për veprimtari botuese.

Inspektorati shtetëror i arsimit

Ndër institucionet e rëndësishme të sistemit arsimor është edhe Inspektorati shtetëror i arsimit I cili funksionon në kuadër të Ministrisë së arsimit dhe shkencës. Inspektorati është përgjegjës për kontrollin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet arsimore përfshirë këtu edhe nivelin universitar. Inspektorati kontrollin e cilësisë e realizon përmes zbatimit të vlerësimit integral në të gjitha institucionet arsimore (shkollat fillore, të mesme dhe universitetet). Gjithësesi në varësi të nivelit realizohen edhe kontrollet. Kështu pra, sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, inspektorati realizon kontrolle në shtatë fusha:

- planin dhe programet mësimore,
- të arriturat e nxënësve,
- të nxënësve dhe mësimdhënësve,
- përkrahja e nxënësve,
- klima në shkollë,
- burimet, dhe
- përparimi e udhëheqja

Ndërsa sa i përket arsimit parashkollor aty bëhet vetëm mbikqyrje inspektuese e institucioneve ndërsa në nivel të arsimit të lartë universitar kontrolli bëhet vetëm aspekt të asaj nëse institucionet e arsimit të lartë respektojnë ligjet.

Qendra e arsimit profesional

Një tjetër institucion që ndihmon në menaxhimin e procesin arsimor është Qendra e arsimit profesional. Detyrat kryesore të qendrës janë si vijon:

- analiza dhe shqyrtimi i sistemeve për arsimin profesional
- zhvillimi i standardeve për kualifikime profesionale;
- programet mësimore;
- trajnimi i mësimdhënësve;
- këshillimi e mentorimi;
- bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përkrahja e partneritetit social.

Qendra menaxhohet nga Këshilli i saj drejtues i cili është i përbërë nga katër përfaqësues nga Qendra, një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, nga një përfaqësues prej odave ekonomike, dhomës së zejtarëve dhe shoqatës së komunave.

Qendra për arsimin e të rriturve

Poashtu në kuadër të sistemit arsimor kemi edhe institucioni Qendra për arsimin e të rriturve, e cila ka për detyrë të përkrah dhe të ndihmoj plotësimin e nevojave të tregut të punës dhe të përmirësoj shkathhtësitë e individëve të cilët do e kishin më lehtë më pas edhe gjetjen e një vendi të punës. Ndër detyrat kryesore janë këto:

- promovimi i arsimit për të rriturit,
- bashkërendimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe me organizatat e tjera për arsimin e të rriturve,
- sigurimi i cilësisë sidomos nëpërmjet vendosjes së standardeve dhe kriterëve për arsimin formal dhe joformal të të rriturve.

Drejtoria e zhvillimit dhe përparimit të arsimit në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive

- Ky është një institucion i veçantë i cili ka për qëllim të zhvilloj arsimin tek pjesëtarët e bashkësive etnike që jetojnë në vend, si dhe të sigurojë nivel më të mirë të arsimit për grupet etnike joshumicë si dhe të punojë në drejtim të forcimit të tolerancës mes bashkësive etnike. Ky institucion është përgjegjës për implemetini e strategjisë për arsimin e romëve dhe strategjisë për arsim të integruar. Në kuadër të drejtorisë funksionojnë disa seksion edhe atë: ai i gjuhës shqipe, gjuhës turke, gjuhës rome, gjuhës boshnjake, dhe gjuhëve tjera.

Qendra kombëtare e provimeve

Detyra kryesore e qendrës kombëtare të provimeve është menaxhimi dhe organizimi i vlerësimit të nxënësve në kuptim të notimit nga jashtë dhe maturës shtetërore. Por përveç provimeve kombëtare, qendra është përgjegjëse edhe për realizimin e testimit në nivel ndërkombëtarë të tillë si Programi për vlerësim ndërkombëtar (PISA) dhe Studimi i trendeve ndërkombëtare në fushën e matematikës dhe studimeve të shkencës (TIMSS).

Përveç organizimit të provimeve, qendra poashtu është përgjegjëse për trajnimin, vlerësimin dhe licenimin e drejtorëve të të gjitha shkollave në vend si dhe kandidatëve potencial për drejtorë.

2. Strategjia e Arsimit në RMV

Qeveritë e RMV në vazhdimësi kanë hartuar plane dhe strategji për avancimin e arsimit në vend. Ndër to është edhe Strategjia Gjithëpërfshirëse e Arsimit e Qeverisë për periudhën 2018-2025 dhe Plani i Veprimit i vitit 2020 përcaktuan veprimet kyçe që do të ndërmerren në vitet e ardhshme për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit. Prioritetet përfshinin zhvillimin e mësimdhënies me në qendër nxënësin, matjen e të nxënit në terma të rezultateve (në vend që të fokusohemi vetëm në përvetësimin e njohurive) dhe prezantimin e një vlerësimi kombëtar. Më konkretisht këto ishin synimet e strategjisë:

- Rritja e ndjeshme e përqindjes së fëmijëve në sistemin parashkollor dhe futja e një viti të detyrueshëm të arsimit parafillor (mosha 5-6).
- Reformimi i kurrikulave dhe programeve për arsimin e detyrueshëm për të rritur rëndësinë dhe atraktivitetin e tyre, duke i përafruar më mirë me fazat e zhvillimit të fëmijëve dhe për t'u fokusuar më shumë në rezultatet e të nxënit
- Mbështetja e zhvillimit dhe përdorimit të vazhdueshëm të teksteve shkollore cilësore duke reduktuar mbështetjen në tekstet shkollore për mësimdhënie.
- Orientimi më i mirë i programeve të arsimit profesional dhe teknik drejt nevojave të tregut të punës.
- Forcimi i kompetencës së stafit mësimdhënës në të gjitha nivelet arsimore
- Forcimi i kapaciteteve menaxheriale dhe drejtuese në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, dhe brenda shkollave, dhe sigurimi i politikave të harmonizuara dhe transparente

- Zhvillimi i një vlerësimi kombëtar deri në vitin 2020 dhe një koncept i ri për Maturën Shtetërore, veçanërisht për nxënësit e shkollave profesionale.³

Qeveria synoi gjithashtu të reformojë kurrikulën për ta bërë mësimin më të përshtatshëm për tregun e punës. Megjithatë, fatkeqësisht këto dokumente strategjike nuk parashtrojnë ndonjë qëllim specifik për sektorin. Ekziston një mungesë e dukshme e objektivave për të rritur rezultatet e të nxënit, pavarësisht performancës së ulët të vendit në vlerësimet ndërkombëtare të studentëve. Strategjisë i mungon gjithashtu një plan zbatimi ose një proces i përcaktuar për të monitoruar progresin.⁴

3. SFIDAT E ARSIMIT NË RMV

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve strategjike dhe ligjore dhe përcaktimin dhe zbatimin e politikave për të gjitha nivelet e arsimit. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i mungojnë kapacitetet teknike për hartimin e politikave të bazuara në fakte ose monitorimin e zbatimit të politikave. Kjo minon zhvillimin e politikave dhe planifikimit strategjik koherent dhe të qëndrueshëm, siç vërehet në ndryshimet e përsëritura në kurrikulë.

Një faktor kryesor që pengon politikëbërjen e bazuar në fakte në Maqedoninë e Veriut janë sistemet e pazhvilluara dhe të papërdorura të të dhënave. Edhe pse ministria zhvilloi dhe zbatoi një Sistem Informativ të Menaxhimit të Arsimit (SMIA) në vitin 2010, ai mbetet me staf të pamjaftueshëm - ka vetëm dy anëtarë të personelit në njësin - dhe nuk është i përdorur si duhet si brenda ministrisë ashtu edhe në të gjithë sistemin arsimor. Bazat e të dhënave qendrore, për shembull, për inspektimin e shkollave dhe rezultatet e provimeve të studentëve nuk janë të integruara me sistemin dhe të dhënat mblidhen disa herë nga shkollat nga pjesë të ndryshme të ministrisë. Të dhënat gjithashtu nuk janë të krahasueshme në të gjithë sektorin,

³ UNICEF. Review of Evaluation and Assessment in Education in North Macedonia. 2019.

⁴ <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/9b99696c-en/index.html?itemId=/content/component/9b99696c-en>

për shembull, Enti Shtetëror i Statistikave (ESSH) dhe sistemi përdorin përkufizime të ndryshme për treguesit kryesorë si braktisja e shkollës.

Në Maqedoninë e Veriut, mungesa e një diskutimi kombëtar, synimeve apo monitorimit në lidhje me përmirësimin e të nxënit është e habitshme. Në nivelin më të lartë, përderisa Strategjia e re Gjithëpërfshirëse e Arsimit është një hap përpara në shumë aspekte - duke përcaktuar veprime të rëndësishme që kanë fituar mbështetje të përgjithshme kombëtare - ajo nuk artikulon asnjë objektiv kombëtar për përmirësimin e rezultateve të të nxënit. Në nivel shkolle, vlerësimi është një proces i vlerësuar, por inkurajon shkollat të përqendrohen në pajtueshmërinë procedurale, në vend që të rishikojnë në mënyrë kritike se si mjedisi i tyre mësimor po i mbështet nxënësit të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Në nivel klase, mësuesve u mungojnë mjetet - qoftë përmes standardeve të të nxënit të fokusuara në rezultate apo burimeve të vlerësimit të lidhura me pritjet mbi kurrikulën - për të zbuluar dhe diagnostikuar nevojat e të nxënit të nxënësve. Kjo bën që shumica dërrmuese e nxënësve të vendit të kalojnë nëpër shkollë pa fituar kompetenca thelbësore. Aktualisht, vlerësimi përqendrohet në identifikimin e personave me arritje shumë të larta - ata që do të dalin mirë në konkurrencën akademike, "olimpiada" - dhe ata me vështirësi në të nxënë. Mësuesve dhe shkollave u mungojnë mjetet për të vlerësuar të nxënit në mënyrë më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.⁵

Performanca e vendit në vlerësimet ndërkombëtare gjithashtu tregon pak prova të përmirësimit. Performanca e leximit në PISA ra me 21 pikë midis 2000 dhe 2015. Në krahasim, Shqipëria fqinje arriti të rriste performancën me 56 pikë, ekuivalente me gati dy vjet shkollim, gjatë të njëjtës periudhë. Në vlerësimin ndërkombëtar PISA 2015, 15-vjeçarët e Maqedonisë së Veriut performuan pothuajse katër vjet prapa bashkëmoshatarëve të tyre nga OECD, me një rezultat mesatar prej 384 në shkencë krahasuar me 493 në vendet e OECD. Vendi shënoi më pak pikë edhe se fqinjët e tij, duke përfshirë Shqipërinë (427 pikë) dhe Malin e Zi (411 pikë), dhe vetëm pak mbi Kosovën (378 pikë).

⁵ UNICEF. Review of Evaluation and Assessment in Education in North Macedonia. 2019.

Në letër, shkollat në Maqedoninë e Veriut kanë një gamë të gjerë mbështetjeje nga e cila mund të mbështeten. Ata marrin vlerësime të jashtme të rregullta dhe bëjnë vetëvlerësimet e tyre. Komunitetet janë gjithashtu të vendosura afër shkollave dhe i financojnë drejtpërdrejt ato. Çdo shkollë ka ekipin e saj mbështetës shumë-profesionist që përfshin një ekspert pedagogjik ("pedagog"), psikolog dhe këshilltar për nevoja të veçanta arsimore. Kjo shkallë e mbështetjes për shkollat individuale është e pazakontë në shumicën e vendeve të OECD. Megjithatë, shumica e shkollave funksionojnë në një kontekst shumë të vështirë. Mungesa e vazhdueshme e financimit dhe mungesa e transparencës në alokimet e fondeve do të thotë se shumë shkolla nuk kanë burime të mjaftueshme për të mbuluar kostot e tyre bazë të funksionimit dhe sigurisht jo për të investuar në përmirësime në mjedisin mësimor. Roli i drejtuesve të shkollës kufizohet nga presionet e jashtme politike lokale, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të udhëhequr në mënyrë efektive përmirësimin e shkollës.

Ligji i ri për arsimin fillor

Në vitin 2019, është miratuar Ligji i ri për arsimin fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/2011, datë 5.8.2019). Ligji përmban dispozita të tilla si: përmirësimi i procesit mësimor dhe mënyra e organizimit të mësimdhënies, forcimi i vlerave themelore kushtetuese në procesin arsimor, si mosdiskriminimi, ndalimi i trajtimit poshtërues të nxënësve dhe personelit të shkollës, vendosja e parimit të përfshirjes së plotë të nxënësve. Aftësia e kufizuar përmes një sistemi mbështetës gjithëpërfshirës duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësit, profesionalizmin e udhëheqjes së shkollës, eliminimin e çdo mundësie të ndëkimit politik, vendosja e një sistemi të organizimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve, promovimi i praktikave dhe ndryshimi i mënyrës se si ata bëjnë praktikën, masat e jashtme e arritjeve të nxënësve për përmirësimin e procesit arsimor (kontrollat ndërkombëtare dhe shtetërore), mbështetjen e pjesëmarrjes së nxënësve në garat ndërkombëtare në fushën e matematikës, informatikës dhe shkencave natyrore, promovimin e shëndetit të nxënësve përmes të ashtuquajturit "mësues të dyfishtë", d.m.th. mësimi i edukimit fizik dhe shëndetësor do të realizohet nga çifti i mësuesit të edukimit fizik dhe mësuesit të shkollës fillore ... Ligji i ri ka

filluar të zbatohet nga viti akademik 2019/2020. Aktet nënligjore që dalin nga ligji i ri aktualisht janë duke u hartuar dhe pësojnë ndryshime në vazhdimësi.⁶

Ligji i ri për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme

Ligji i ri për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161 / 2019 nga 5.8.2019), u miratua në vitin 2019, i cili promovon dukshëm zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore. dhe shkollat e mesme dhe prezanton një model për zhvillimin dhe promovimin (përmirësimin) e tyre në karrierë.

Për të realizuar zbatimin e strategjisë duhet siguruar financimi të duhur. Financimi, në thelb, është i pari faktor për cilësi të arsimit , për shkak se investimi në arsim nënkuptoj investim në të ardhmen. Sipas të dhënave të marra nga Enti shtetëror i statistikave, vendi ynë për arsimin ndan diku rreth 3.7% nga PBB, që është për 26% më pak se sa shuma që ndajnë vendet E OECD, e cila arrin në 5.0% nga PBB. Sipas të dhënave të marra nga Enti shtetëror i statistikave, vendi ynë për arsimin ndan diku rreth 3.7% nga PBB, që është për 26% më pak se sa shuma që ndajnë vendet E OECD, e cila arrin në 5.0% nga PBB Veçanari, rënie të theksuar është vërejtur përgjatë periudhës 2011 deri në 2016, kur shpenzimet për arsim në vendin tonë si përqindje e PBB-së, janë zvogëluar nga 4.6% në 3.7 %. Në këtë drejtim lëviz edhe edhe rënia e përqindjes së shpenzimeve që kishte veçuar Qeveria për arsim, dhe atë nga 13.3% në 2011 vit, në 11.6% në 2016. Kjo përqindje e shpenzimeve që ishin ndarë për arsimin që është nën vlerën e shpenzimeve të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara e që është nga 15-20%.⁷

Mungesa e financave me të cilën përballlet arsimit nuk është vetëm pasojë e uljes së përqindjes së alokimit të arsimit nga PBB-ja. Një arsye kryesore për mungesën e financave në arsim është shpenzimi joracional i burimeve të kufizuara financiare në arsim. Ekzistojnë të dhëna për shkallën e lartë të nxënësve/mësimdhënësve në drejtim negativ, gjegjësisht ka një

⁶ https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/national-reforms-school-education-42_en

⁷ <https://www.mchamber.mk/default.aspx?mId=3&evid=37301&lng=1>

numër më të madh të mësuesve në një shkollë në raport me numrin e nxënësve, ndërsa numri i orëve për mësuesit mbetet i pandryshuar.

Kur bëhet fjalë për financimin e arsimit, si anë negative duhet përmendur procesi i decentralizimit (2005), kur kompetenca për financimin dhe menaxhimin e shkollave iu transferua komunave në bashkëpunim me pushtetin qendror. Praktika ka treguar se kryetarët e bashkive ende nuk kanë një ndërgjegjësim shumë të zhvilluar për rolin e arsimit në shtet dhe vendimet e tyre për financimin lidhen me shpërndarjen e fondeve, që zbret në nivel vetëm të pagesës së pagave të mësuesve, me gjithsej 65%, dhe prokurimin e mallrave dhe shërbimeve 33, 5%, por jo edhe në investimin e fondeve në arsim.

Shpërndarja jo e duhur, veçanërisht e shkollave profesionale, sipas qarqeve, sipas nevojave përkatëse të vetëqeverisjes lokale dhe ekonomisë në tërësi, është një tjetër arsye për shpenzimet joracionale të financave në arsim. Në këtë drejtim, ofrohen kualifikime të papërshtatshme për nevojat reale në nivel lokal, gjë që shkakton realizim joadekuat të trajnimit praktik dhe përvetësimin e shkathtësive praktike tek nxënësit. Kjo kontribuon në pakënaqësinë e punëdhënësve me profesionistë të arsimuar por jo të trajnuar dhe rritjen e papunësisë.

Edhe pse ekziston një kornizë solide ligjore, e cila duhet të ngrerë te gjithë segmentet e shoqërisë në procesin arsimor, ekziston një sërë e metash dhe problemesh që vështiesojnë qasjen e duhur apo janë shkak që segmente të caktuara të shoqërisë kanë një shkallë të lartë të braktisjes në sistemin arsimor. Kjo pjesë e dokumentit do të përqendrohet tek raportet e organizatave ndërkombetare dhe OJQ-te vëzhguese dhe analizat e tyre lidhur me të metat e sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë.

Sipas Raportit të SMZH për 2009-en, është jashtëzakonisht vështirë në Republikën e Maqedonisë që të integrohen segmente të caktuara të shoqërisë në sistemin arsimor. Ky raport specifikon problemet e:

- Femijëve me nevojë të posaçme- ekzistojnë shkollat e posaçme fillore për femijë me nevojë të posaçme ndërsa janë formuar klasa të posaçme në skollat fillore të rrefullta. Vërejtja, është inkurajuar edhe përfshirja e femijëve me nevojë të

posacme ne klasat e rregullta. Megjithate, ende nuk ka nje system qe te vendos perqindjen e femijeve te tille tek popullata dhe te siguroje perfshirhjen e tyre ne arsim, ne vecanti duke pasur parasysh paragjykimin e fuqishem ne mesin e popullates (dhe arsimtareve) kundrejt pjesetareve te ketyre grupeve.

- Femije ne zona rurale, vecanerisht ne vendbanime te largeta malore- besohet shume se ekzistojne kontraste midis shkalles se regjistrimit ne zonat urbane dhe rurale; sidoqofte nuk ka mbledhje sistematike te te dhenave qe do te mbeshtesin pohimet e tilla.
- Femijeve qe u perkasin disa komuniteteve etnike- Eshte e dukshme se perfshirja ne grupet etnike joshumice nuk eshte e kenaqshme. Vecanerisht popullata rome perballet me perjashtimin e institucioneve arsimore per shkak te varferise. Shterngesa tradicionale dhe frika nga arsimi, posacerisht qe ka ate beje me vajzat e komuniteteve rome, turke dhe shqiptare, gjithashtu ka cuar ne perjashtimin nga arsimi te ketyre femijeve (vecanerisht par arsimi fillor).

Sipas raportit te Komisionit te KB mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor (2007), ekziston nje perqindje e romeve te cilet nuk kane ndonje dokumentacion te duhur per te gezuar te drejtat e tyre. Pa dokumentacionin e nevojshem, popullata rome perjashtohet nga qasja ne arsim.

Komisioni I njejte ka ardhur ne perfundim se nuk ka perpjekje te mjaftueshme per te promovuar politikat ne gjuhet locale. Komisioni ne raportin e lartepermendur, kerkon qe te kete me teper perkthyes ne te gjitha gjuhet e komunitetete joshumice.

Ekziston nje shkalle e larte e ndaleses nder femijet shqiptare dhe turq ne institucionet e nivelit te mesem dhe te larte. Komisioni “inkurajon qeverine qe te ngreje scilesine qe rakomandon se Shteti zmadhon perpjekjet per te zvogeluar shkallen e braktisjes ne nivelin e arsimi te mesem dhe te larte nder femijet shqiptare dhe turq”. Ne kete kuader, Komisioni inkurajon Republiken e Maqedonise qe ta permiresoje cilesin e mesimit ne shkollat shqipe dhe

turke, nder te tjera me ane te sigurimit te disponueshmerise se librave shkollore ne gjuhet e pakicave dhe trajnim adekuat te mesuesve qe japin mesim ne keto gjuhe.

SMZH e ben te dukshme gjendjen shqetesuese te popullates rome. Sipas MDG(2009), 20.6% e romeve jane analfabete. Ne vitin 2002, 33% e popullates rome deshtoi ne kryerjen e arsimit fillor ndersa nga 67% te mbetur 93% perfundoi arsimin fillor. Keto gjetje ilustrojne me shembuj se ka nevojte per te vleresuar problemet e perfshirjes sociale ne sektorin e arsimit si mjet per te permiresuar qeverisjen ne kete lemi.

Aq me shume, nuk ka politika qe do te terheqin dhe mbeshtetin romet ne sherbimin e trajnimit te mesuesve, keshtu qe ekziston mungese e mesuesve rome ne nivelet parashkollore dhe fillor. Mesuesit jo-rome shpesh ngarkohen me stereotipa etnike negative dhe paragjykime kundrejt nxenesve rome.

Te gjitha gjetjet dhe te dhenat nga burime te ndryshme e bejne te patjetersueshme per te ndermarre nje analize per qeverisjen ne menyre qe te vleresohen politikat dhe efekti ityre mbi crrenjosjen ose rritjen e perjashtimit social ne sektorin arsimor ne Republiken e Maqedonise.⁸

4. NDIKIMI I POLITIKËS NË ARSIM NË RMV

Sistemi arsimor në Maqedoninë veriore është i ndikuar nga politika dhe korrupsioni. Shteti është mesatarisht i përgatitur në fushën e arsimit. Është bërë progres me miratimin e Ligjit të ri për Arsimin Fillor dhe Ligjit të ri për Mësimdhënësit në Shkollat Fillore dhe të Mesme dhe me reformat në aftësimin profesional. Futja e masave gjithëpërfshirëse në Strategjinë e Arsimit 2018-2025 po ecën ngadalë. “Rekomandimet nga raporti për vitin 2019 janë adresuar vetëm pjesërisht, andaj edhe janë të vlefshme”, thuhet ndër të tjera në raportin e Komisionit Evropian, kjo thuhet në raportin e Komisionit Evropian, gjegjësisht në Kapitullin 24.⁹

Rekomandimet e Komisionit Evropian në drejtim të ulje së këtyre ndikimeve janë si vijon:

⁸ Metodologjia e vleresimit te qeverisjes dhe ndikimi i saj ne perfshirjen sociale ne sektoret e arsimit dhe shendetesise ne Republiken e Maqedonisë, 2011

⁹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/north_macedonia_report_2020.pdf

- Zbatimi i Strategjisë së re të Arsimit, ku grup i targetuar do të jenë fëmijët parashkollorë.
- Rritja e mbështetjes për trajnime dhe forma të tjera të zhvillimit profesional të mësuesve.
- Përmirësimi i gjithëpërfshirjes dhe arsimit cilësor për të gjithë, veçanërisht në moshën parashkollore, për të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta dhe romët.

Sipas Komisionit për Luftë të kundër për korrupsionit, ekziston një problem shumëvjeçar me punësimin e mësuesve në shkollat fillore dhe të mesme për një periudhë të caktuar, pa shpallje publike deri në tre muaj dhe me shpallje publike për pjesën tjetër të vitit shkollor, që paraqet pasiguri, presion, varësia dhe rrethanat e favorshme dhe potenciali për ndikim politik, sjelljet korruptive. Mbajtësit e funksioneve publike përgjithësisht shpërfillin detyrimet ligjore kur vendosin për punë në të cilat ata ose të afërmit e tyre kanë një interes privat dhe janë të detyruar t'i përfaqësojnë dhe përjashtojnë ata në zhvillimin e procedurave të tilla si përfaqësimi ose krijimi i një konflikti interesi, të cilat janë mundësi të mundshme. për korrupsion.

Sipas Komisionit, pesë pikat e dobta që përcaktojnë rrezik për praktikën korruptive në shkollat dhe përplasja të interesave:

- Dallime të konsiderueshme dhe kompetenca të parregulluara diskrecionale në punësimin në arsim;
- Stafi dhe kapacitetet e pamjaftueshme profesionale të inspektoratit shtetëror për arsim;
- Ndërgjegjësimi i ulët për trajtimin e korrupsionit në institucionet arsimore;
- Mungesa e rregulloreve të sakta ligjore për përdorimin e mjeteve ndihmëse didaktike në mësimdhënie;
- Mungesa e procedurave precize të prokurimit publik, të cilat në sistemin arsimor kryesisht zbatohen jashtë Ligjit për Prokurim Publik;
- Mungesa e akteve nënligjore për mënyrën e rregullimit të dhënies me qira të patundshmërive institucioneve arsimore;

- Cilësi dhe siguri e pamjaftueshme juridike në arsimin e lartë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve shkencore dhe akreditimin e programeve të studimit.

Funksionimi dhe menaxhimi i institucioneve të arsimit publik, përfshirë universitetet, është i politizuar. Përpjekja e fundit për reformimin e arsimit fillor që u paralajmërua në fund të vitit 2020 fitoi interes të madh në publik dhe bëhet fjalë për një politizim të ri kryesisht për shkak të qasjeve të reja në studimin e historisë. Kjo temë e lë në hije të gjithë debatin dhe e largon vëmendjen nga përfitimet e mundshme të reformës. Infrastruktura arsimore, burimet dhe kapacitetet kanë nevojë për përmirësime dhe investime thelbësore. Në vend nuk ka një strategji formuese për të rritur fokusin dhe investimet në kërkim dhe zhvillim¹⁰

Ligji për vetadministrim lokal dhe ndikimi i Procesit edukativo-arsimor në maredheniet nderetnike

Në përgjithësi kur bëhet fjalë për procesin arsimor dhe maredheniet nderetnike tek ne, duhet patur parasysh faktin se Republika e Maqedonise Veriore është bashkësi multietnike, multifunksionale dhe multikulturore. Mënda kësaj bashkësie jetojnë një numër relativisht i madh i grupeve etnike të cilat edhe dallohen me veti të ndryshme historike, kulturore, traditë dhe psikologjike të tyre. Do të thotë se Republika e Maqedonise Veriore është një shtet i tillë në të cilin është shoqëri multietnike me specifikat e sajë etnokulturore.

Në kuadër të Republikës së Maqedonise Veriore ka komuna dhe mjedise me përzierje të vogël etnike mirëpo në anën tjetër ka komuna me përzierje të madhe etnike. Kur bëhet fjalë për komunën në tërësi mund të themi se ajo është një bashkësi e të gjitha atyre grupeve etnike të cilat jetojnë në atë hapësirë. Periudha bashkëkohore karakterizohet me një proces intenziv të zhvillimit dhe ndryshimeve shoqërore në të gjitha sferat. Krahas ndryshimeve të karakterit global, ndryshime ka edhe të karakterit lokal komunal siç është decentralizimi i

¹⁰ <https://bti-project.org/en/reports/country-report/MKD>

pushtetit qendrore dhe bartja e disa ingjencave ne pushtetin lokal si institucion shoqeroropolitik I cili kontribon per demokratizimin e mardhenieve shoqerore.

Zhvillimi I veteqeverisjes locale eshte me nje domethanje te madhe per motivimin e qytetareve per nje jete demokratike dhe per perparimin dhe respektimin e identitetit te bashkesive. Prandaj njerzit sot nga kjo bashkesi locale presin ti arrijne disa qellime te caktuara qe kane karakter jetesore e ne mesine atyre qellimeve eshte edhe sistemi arsimor. Kjo veteqeverisje locale dallohet me mjaftte sisteme dhe nensisteme. Nje nenstitem I atille eshte procesi edukativo-arsimor.

Padyshim se sistemi arsimore neshoqerite multietnike sic eshte ne Republiken e Maqedonise se Veriut luan rol mjaftte te madh. Pesa dhe roli I procesit edukativo arsimor qendron aty se ai eshte nje process fundamental shoqerore I oraganizuar I cili mundeson edukim dhe arsimim si dhe bartjen sistematike te te gjitha asaje qe eshte dhene si fryt I veprimtarise njerezore. Pra, arsimimi dhe edukata jane pjese e jetes se nje bashkesie te perbashket, I cili mundeson zhvillimin e asaj bashkesie. Pa nje process te ketille kjo bashkesi nuk do te ishte e ketille sic eshte tani, dhe se zhvillimi shoqerore nuk do ta ishte I mundur. Pa nje process te ketille dok do te kishte as bashkesi njerezore, nuk do te kishte culture civilizim qe do te thote se procesi arsimore eshte baza e mbajtjes dhe e zhvillimit te asaj bashkesie njerezore.

Ne ligjin per veteqeverisje lokale ne nenin 22 ku flitet per kompetencat e komunes perveç shumë kompetencave tjera thuhet :“Komuna eshte kompetente per themelimin, financimin dhe administratimin e shkollave fillore dhe te mesme ne bashkepunim me pushtetin qendrore ne perputhshmeri me ligjin”.

Procesi I zhvillimit te shoqerise ng ate gjitha aspektet mvaret nga kualiteti, qellimet dhe detyrat e procesit edukativo-arsimor. Duke patur parasysh faktin se Maqedonia e Veriut eshte nje bashkesi heteroetnike, dhe se kjo bashkesi e ka edhe strukturen dhe hierarkine e saj, nje teme e cila ka te beje me marrdhëniet ndëretnike dhe procesin edukativo-arsimor e cila perputhet si ne nivelin republikan ashtu edhe ne nivelin komunal gjegjesisht te veteqeverisjes lokale është shumë e rëndësishme.

Kuptohet se keto dy kategori: maredheniet nderetnike dhe procesi edukativo-arsimore jane ne lidhshmeri kauzale dhe e kane anen shoqerore dhe pedagogjike. Marredheniet nderetnike dhe procesi edukativo-arsimore ne mjediset e perziera etnike jane ne marredhenie te ndikimit dhe lidhshmerise reciproke. Nga njera ane pjesmaresit ne procesin edukativo-arsimore ne vehte e bartin gjendjen aktuale te marrëdhënieve nderetnike, kurse ne anen tjetër e gjithë ajo e cila ndodhe ne procesin edukativo-arsimore reflektohet ndaj marrëdhënieve nderetnike qofte ne aspektin global apo ne ate parcial. Me fjale tjera gjendja ne procesin edukativo arsimore porosite kulturore vlerore dhe ato politike te cilat jane permbajtja e atyre materialeve, si dhe marrëdhënia e arsimitareve dhe nxenesve ndaj atyre porosive, ndikojne ndaj marrëdhënieve nderetnike. Kure flitet per anen shoqerore duhet potencuar ajo se Republika e Maqedonise se Veriut jeton dhe frymon ne nje system tjetër shoqerore, gjegjesisht ne tranzicion I cili ka karakteristikat e veta specifike.

Shikuar ne aspektin socio-psikologjik Republika e Maqedonise se Veriut si bashkesi shumetnike paraqet nje kornize me te gjere shoqerore te aktiviteteve dhe parimeve egzistenciale te te gjitha grupeve etnike e cila tuhet te iu siguroje kushte per jete te perbashket.

Ne ate kontekst bashkesia shumnacionale ndikon ne karakterin dhe kahjet e zhvillimit te arsimit, ne qellimet dhe detyrat, permbajtjen dhe ne zhvillimin e tersishe me personalitetit dhe ne socializimin e te rinjve, vecanerisht ne ndertimin e identitetit te tyre etnik dhe kulturore, per njohje me te mire reciproke dhe bashkepunim me pjestaret e grupeve tjere etnike si dhe per formimin e vetedijes dhe ndjenjes se perkatesise se bashkesise shumetnike. Me fjale te tjera bashkesia shumetnike duhet te krijojë kushte per integrimin e te gjithve si kusht per egzistimin e asaj bashkesie. Ky element integrative do te fitoj peshe dhe perspective nese kjo bashkesi shumetnike perjetohet si bashkesi globale e te gjitha grupeve etnike. Kesaj problematike I eshte kushtuar rendesi edhe ne aspektin nderkombetare. Ne paktin nderkombetare lidhur me te drejtat ekonomike, shoqerore dhe kulturore ne nenin 13 thuhet keshtu:

“Shtetet pale ne kete pakt njohin te drejten e cdo presoni per arsim. Ata jane ten je mendimi se arsimi duhet te synoje ne lulezimin e plote te personallitetit njerezore dhe te ndjenjes se dinjitetit te tij, te forcoj respektin per te drejtat e njeriut dhe lirite themelore. Ata, vec kesaj jane ten je mendimi se arsimi duhet ti mundesoje cdo personi te jete ne gjendje te

luaj nje rol te dobishem ne nje shoqeri te lire, te favorizoj mirekuptimin, tolerance dhe miqesine ndermjet te gjitha kombeve dhe te gjitha grupeve racore, etnike ose fetare dhe te inkurajoje zhvillimin e veprimtarive te Kombeve te Bashkuara per ruajtjen e paqes". Meqe ku process eshte I lidhur me edukimin e te rinjve, te cilet jane ne formim e siper te personalitetit te tyre duhet ta kemi parasysh ate se nesa keta te rinje edukohen dhe arimohen ne menyre te gabuar, dhe se zhvillohen nen ndikimin e paragjykimeve etnike atehere nuk mund te kemi maredhenie stabile etnike.

Kure behet fjale per procesin edukativo-arsimore tek ne, duhet patur parasysh dhe eshte shume me rendesi se sit e rinjte e zhvillojne identitetin e tyre, ne formen e patriotizmit apo ne frymen etnocentrike, ose ne frymen e kosmopolitizmit. Parashtrohet pyetja ku qendron roli I procesit edukativo-arsimor ne mjediset shumetnike? Duke marre parasysh ate se qendrimet sociale dhe etnike zhvillohen me ane te te mesuarit social-socializimit, mund te thuhet se roli I procesit arsimore ne mjediset multietnike eshte tejte I madh. Sepse procesi arsimore vepron ne drejtim te zhvillimit te sjelljeve dhe qendrimeve te nxenesve ndaj grupeve etnike.

Njohurite dhe informatat ndaj grupeve tjera etnike, jane baze per ndryshimin e qendrimeve te tanishme dhe fitimin e qendrimeve te reja. Diturite dhe njohurite e reja ndaj te tjerve mund te kene efekte te ndryshme, mund te jene positive por edhe negative. E gjithë kjo mvaret nga karakteri I sistemit arsimore. Pozitive do te jene atehere kur shteti ne tersi apo komuna si pushtet local zhvillon nje system arsimore egalitare ku te gjithë pjestaret e grupeve etnike do ta gjenin vendin e tyre. Kurse negative do te jene atehere kur sistemi arsimore nuk do te ishte I barabarte per te gjithë, dhe se ne kete rast do te dominonin paragjykimet dhe stereotipet etnike si baze dhe faktore I tensionimit te mardhenieve nderetnike. Kur behet fjale per procesin edukativo-arsimor ne bashkesite shumetnika mund te them se burimi kryesore prej nga edukohen dhe arsimohen te rinjte jan kuadri arsimore (me qendrimet dhe botekuptimet e tyre) dhe tekstet shkollore.¹¹

¹¹ Vizione, 1/2004, Korrik 2004, Shkup

KAPITULLI III - ANALIZA E INDIKATORËVE MBI ARSIMIN

Pjesa vijuese e punimit fokusohet në analizën e të dhënave statistore mbi arsimin në nivel të shtetit, ku për bazë merren raportet vjetore të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, ku do të analizohen indikatorë si numri i shkollave aktive, numri i nxënësve të regjistruar, numri i paraleleve, numri i mësuesve, etj.

3.1. ANALIZA E INDIKATORËVE NË NIVEL REPUBLIKAN

3.1.1. SHKOLLIMI FILLOR NË NIVEL REPUBLIKAN

Bazuar në tabelën më lartë mund të shikojmë që në 11 vitet e analizuara (për të cilat ka të dhëna zyrtare nga Enti Shtetëror i Statistikave), mund të vërhet se tek numri i shkollave aktive nuk ka ndonjë lëvizje të theksuar, në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 996 shkolla ndërsa në vitin shkollor 2017-2018 numri i shkollave aktive ishte 989, pra gjatë kësaj periudhe janë mbyllur gjithsej 7 shkolla në nivel republikan.

Nga ana tjetër kemi një rritje të vogël të numri të paraleleve aktive, nëse në vitin shkollor 2007-2008 numri i paraleleve ishte 10,647 në vitin shkollor 2017-2018 ky numër është rritur në 11,075 paralele, që paraqet rritje për 428 paralele. Ndërsa përderisa kemi rritje të numrit të paraleleve, kemi ulje të numrit të nxënësve të regjistruar. Nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 222,359 nxënës të regjistruar në tërë shkollat në nivel republikan, në vitin shkollor 2017-2018, kemi një ulje të numrit të nxënësve të regjistruar dhe ky numër arrin në 192,488. Pra, për gjatë periudhës 11 vjeçare të analizuar kemi një ulje prej 29,911 ose 13.45% që paraqet në trend rënës negativ.

Së fundmi, nëse numri i nxënësve shënon rënie nga viti në vit, e kundërta ndodh me numri e mësuesve të punësuar. Kështu, nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 14,308 mësues me orar të plotë dhe 1,022 me orar të shkurtuar, në vitin shkollor 2017-2018, kemi rritje të numrit të mësuesve të punësuar, në 15,726 me orar të plotë dhe 2,565 me orar të shkurtuar.

Tabela 1 - Shkollat e rregullta fillore, klasat, nxënësit dhe mësuesit në nivel shtetëror

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve		Numri i mësuesve					
			Gjithsej	Nxënëse të gjinisë femërore	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Gjithsej	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2007/2008	996	10,647	222,359	107,755	15,330	9,572	14,308	8,992	1,022	580
2008/2009	993	10,692	216,180	104,445	15,930	10,098	14 605	9,347	1,325	751
2009/2010	989	10,716	210,381	101,765	16,144	10,455	14,725	9,661	1,419	794
2010/2011	990	10,720	204,439	98,951	16,703	10,899	15,049	9,933	1,654	966
2011/2012	986	10,713	198,856	96,433	17,129	11,318	15,075	10,118	2,054	1,198
2012/2013	991	10,684	195,311	94,695	17,193	11,463	14,986	10,176	2,207	1,287
2013/2014	988	10,877	191,051	92,461	17,219	11,576	14,896	10,217	2,323	1,359
2014/2015	986	10,887	192,165	93,106	17,628	11,990	15,297	10,596	2,331	1,394
2015/2016	988	10,709	185,992	89,949	17,641	12,065	15,206	10,583	2,435	1,482
2016/2017	993	11,427	192,715	93,334	17,887	12,363	15,373	10,854	2,241	1,401
2017/2018	989	11,075	192,448	93,118	18,291	12,732	15,726	11,144	2,565	1,588

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

Tabela vijues ofron të dhëna shtesë rreth mesatares së disa indikatorëve të përmendur më lartë. Ashtu siç u përmend më lartë, ku u vërejt se numri shkollave lartë poshtë ka ngelur i njëjtë, me lëvizje të vogla, ku kemi rritje të vogël të numrit të paraleleve por zvogëlim të numrit të nxënësve të regjistruar, nga ku rezulton që:

- Numri mesatar i nxënësve për shkollë në 11 vitet e analizuara më poshtë lëviz me shënon rënie, nga 223.3 nxënës për shkollë në vitin shkollor 2007-2008, në 194.6 nxënës për shkollë në vitin shkollor 2017-2018.
- Numri mesatar i nxënësve në një klasë shënon rënie nga 20.8 në vitin shkollor 2007-2008, në 17.4 nxënës në një klasë në vitin shkollor 2017-2018.

- Raporti nxënës-mësues poashtu shënon rënie, nëse në vitin shkollor 2007-2008 një mësues ishte përgjegjës për 14.5 nxënës, në vitin shkollor 2017-2018 ky raport është një mësues me 10.5 nxënës.
- Raporti mësues për shkollë poashtu shënon ndryshim por në këtë rast ai është pozitiv, nëse në vitin shkollor 2007-2008 një shkollë mesatarisht ka pasur 15.4 mësues, në vitin shkollor 2017-2018, ky numër është rritur në 18.5 mësues për një shkollë.

Tabela 2 - Treguesit bazë për shkollat fillore të rregullta, fillimi i vitit shkollor në nivel shtetëror

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i klasave	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i nxënësve për shkollë	Numri i nxënësve në një klasë	Numri i nxënësve për mësues	Numri i mësuesve për shkollë
2007/2008	996	10,647	222,359	15,330	223.3	20.8	14.5	15.4
2008/2009	993	10,692	216,180	15,930	217.7	20.2	13.6	16.0
2009/2010	989	10,716	210,381	16,144	212.7	19.6	13.0	16.3
2010/2011	990	10,720	204,439	16,703	206.5	19.0	12.2	16.9
2011/2012	986	10,713	198,856	17,129	201.7	18.6	11.6	17.4
2012/2013	991	10,684	195,311	17,193	197.1	18.3	11.4	17.3
2013/2014	988	10,877	191,051	17,219	193.4	17.6	11.1	17.4
2014/2015	986	10,887	192,165	17,628	194.9	17.6	10.9	17.8
2015/2016	988	10,709	185,992	17,641	188.3	17.4	10.5	17.9
2016/2017	993	11,427	192,715	17,887	194.1	16.9	10.7	18.0
2017/2018	989	11,075	192,448	18,291	194.6	17.4	10.5	18.5

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

Tabela vijuese ofron të dhëna mbi arsimin fill or të ndarë nëpër rajone planore. Nga tabela mund të vërehet se numër më të madh të shkollave ka rajoni i Pellagonisë (175 shkolla), i pasuar nga rajoni i Shkupit (157 shkolla) dhe rajoni i Pollogut (148 shkolla). Sa i përket numrit të paraleleve listës i prinë rajoni i Shkupit me gjithsej 2,943 paralele, i pasuar nga rajoni Pollogut me 2,038 dhe rajoni Jug-Lindor me 1,330 paralele. Sa i përket numrit të nxënësve të regjistruar në të gjitha klasat e ciklit fillor, siç pritet i prinë rajoni i Shkupit me gjithsej 65,302 nxënës, i pasuar nga rajoni Pollogut me 32,097 nxënës dhe rajoni i Pellagonisë me 19,946 nxënës. Numër më të madh të mësuesve të punësuar ka rajoni i Shkupit (4,796 mësues), i pasuar nga rajoni Pollogut (3,236 mësues) dhe rajoni Jug-Lindor (2,161 mësues).

Nëse analizojmë mesataren e indikatorëve, gjegjësisht raportin me numrit të nxënësve, numrit të shkollave dhe numrit të mësuesve, do të kemi rezultatet si vijon:

- **Raporti Nxënës/Mësues**

Raport më të vogël nxënës/mësues ka rajoni Jug-Perëndimor me 8.5, i pasuar nga rajoni Lindor me 8.6, rajoni Veri-Perëndimor me 9.2, rajoni Lindor me 9.3, rajoni i Pellagonisë me 9.7, rajoni i Pollogut me 9.9, rajoni i Vardarit me 10.8 dhe rajoni i Shkupit me 13.6 nxënës për një mësues

- **Raporti Nxënës/Shkollë**

Raport më të ulët nxënës/shkollë ka rajoni Pellagonisë me 114, i pasuar nga rajoni Jug-Lindor me 119.9, rajoni Lindor me 145.4, rajoni Jug-Perëndimor me 148.3, rajoni Vardarit me 163, rajoni Veri-Lindor me 169.8, rajoni Pollogut me 216.9 dhe rajoni Shkupit me 415.9 nxënës për një shkollë.

- **Raporti Mësues/Shkollë**

Raport më të lartë mësues/shkollë, gjegjësisht numër më të madh të mësuesve të punësuar për një shkollë ka rajoni Shkupit me 30.5 mësues për një shkollë, i pasuar nga rajoni Pollogut me 21.9 mësues, rajoni Veri-Lindor me 18.5 mësues, rajoni Jug-Perëndimor me 17.4, rajoni Lindor me 15.7, rajoni i Vardarit me 15.1, rajoni Jug-Lindor

me 13.9 dhe së fundmi rajoni i Pellagonisë me një raport prej 11.7 mësues për një shkollë.

Tabela 3 - Shkollat e rregullta fillore, klasat, nxënësit dhe mësuesit, sipas rajoneve – viti shkollor 2017-2018

	Shkolla	Paralele	Nxënës		Mësues					
			Gjithsej	Nxënëse femra	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Gjithsej	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Gjithsej	989	11,075	192,448	93,118	18,291	12,732	15,726	11,144	2,565	1,588
Rajoni Vardarit	81	762	13,206	6,426	1,221	921	1,053	803	168	118
Rajoni Lindor	91	856	13,227	6,365	1,425	1,028	1,154	852	271	176
Rajoni Jug-Perëndimor	124	1,330	18,384	8,902	2,161	1,353	2,039	1,281	122	72
Rajoni Jug-Lindor	118	889	14,152	6,958	1,642	1,129	1,128	810	514	319
Rajoni Pellagonisë	175	1,247	19,946	9,581	2,055	1,498	1,668	1,275	387	223
Rajoni Pollogut	148	2,038	32,097	15,383	3,236	1,967	2,886	1,759	350	208
Rajoni Veri-Lindor	95	1,010	16,134	7,787	1,755	1,150	1,466	974	289	176
Rajoni I Shkupit	157	2,943	65,302	31,716	4,796	3,686	4,332	3,390	464	296

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

3.1.2 SHKOLLIMI I MESËM NË NIVEL REPUBLIKAN

Në periudhën 11 vjeçare të analiuar në tabelën e mëposhtme lidhur me indikatorët e arsimit të mesëm në nivel republikan, mund të vërehet se tek indikator i numrit të shkollave, kemi një rritje të numrit të shkollave, pra themelimi të shkollave të reja. Nëse në vitin shkollor 2007-2008 në nivel shteti kemi pasur gjithsej 105 shkolla të mesme, në vitin shkollor 2017-2018 kemi rritje të numrit të shkollave për 26 shkolla, duke arritur në gjithsej 131 shkolla të mesme aktive në nivel shteti. Një rritje e vogël shënohet edhe numri i paraleleve që kanë funksionuar në kuadër të këtyre shkollave, nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 3,228 paralele

në vitin shkollor 2017-2018 numri i paraleleve është rritur në 3,482 pra kemi themelim të gjithsej 260 paralele të reja.

Nëse tek dy indikatorët e analizuar mësipër, vërehet se ka rritje, e njëjta gjë nuk mund të thuhet sa i përket numrit të nxënësve të regjistruar në këto shkolla. Nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 94,545 nxënës të regjistruar në shkollat e mesme në nivel republikan, në vitin shkollor 2017-2018 numri i nxënësve të regjistruar ka rënë në 71,458. Kjo paraqet një ulje prej 23,087 nxënës apo 24.42% më pak nxënës të regjistruar për 11 vite të analizuar, që paraqesi indikator shqetësues.

Nga ana tjetër, sa i përket numrit të mësuesve të punësuar, në vitin 2007-2008 kemi pasur gjithsej 6,445 mësues (5,445 me orar të plotë dhe 1,000 me orar të shkurtuar), në vitin shkollor 2017-2018 kemi gjithsej 7,445 mësues të punësuar (6,385 me orar të plotë dhe 1,063 me orar të shkurtuar).

Tabela 4 - Shkollat e rregullta të mesme, klasat, nxënësit dhe mësuesit në nivel shtetëror

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve		Numri i mësuesve					
			Gjithsej	Nxënëse femra	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Femra	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2007/2008	105	3,228	94,545	44,352	6,445	3,695	5,445	3,086	1,000	609
2008/2009	108	3,267	93,843	44,595	6,599	3,936	5,711	3,297	888	539
2009/2010	111	3,372	95,343	45,820	6,880	4,029	5,940	3,432	940	597
2010/2011	111	3,433	94,155	45,292	7,088	4,151	6,020	3,487	1,068	664
2011/2012	114	3,477	93,064	44,884	7,265	4,256	6,152	3,574	1,113	682
2012/2013	113	3,459	89,884	42,975	7,391	4,294	6,240	3,592	1,151	702
2013/2014	113	3,455	86,418	41,186	7,322	4,314	6,209	3,628	1,113	686
2014/2015	116	3,474	83,522	40,376	7,402	4,396	6,317	3,712	1,085	684
2015/2016	117	3,497	80,295	38,330	7,341	4,340	6,298	3,691	1,043	649
2016/2017	132	3,533	76,394	36,038	7,420	4,407	6,377	3,760	1,043	647

2017/2018	131	3,482	71,458	34,059	7,445	4,488	6,382	3,819	1,063	669
------------------	-----	-------	--------	--------	-------	-------	-------	-------	-------	-----

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

Ndërlidhur me të dhënat e ofruar në tabelën paraprakte, tabela vijuese ofron të dhënat mesatare për disa indikatorë dhe atë:

- Numri i nxënësve për një shkollë ka rënë për 355.4 nxënës, në 11 vitet e analizuara në tabelë. Nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur 900 nxënës për një shkollë, në vitin 2017-2018 kemi vetëm 545 nxënës për një shkollë.
- Numri mesatar i nxënësve në një klasë ka rënë për gati 9 nxënës, ku në vitin shkollor 2007-2008 mesatarisht një klasë ka pasur 29.3 nxënës, në vitin shkollor 2017-2018, ku numër ka rënë në 20.5.
- Numri mesatar i nxënësve për një mësues ka rënë për 5, nga 14.7 nxënës për një mësues sa kishte në vitin shkollor 2007-2009 ka rënë në 9.6 nxënës për një mësues në vitin shkollor 2017-2018.
- Poashtu kemi rënie edhe të numrit mesatar të mësuesve për një shkollë, ku në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur mesatarisht 61.4 mësues për një shkollë, ndërsa në vitin shkollor 2017-2018 ky numër ka rënë në 56.8.

Tabela 5 - Treguesit bazë për shkollat e mesme të rregullta, fillimi i vitit shkollor në nivel shtetëror

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i klasave	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i nxënësve për shkollë	Numri i nxënësve në një klasë	Numri i nxënësve për mësues	Numri i mësuesve për shkollë
2007/2008	105	3,228	94,545	6,445	900.4	29.3	14.7	61.4
2008/2009	108	3,267	93,843	6,599	868.9	28.7	14.2	61.1
2009/2010	111	3,372	95,343	6,880	858.9	28.3	13.9	62.0
2010/2011	111	3,433	94,155	7,088	848.2	27.4	13.3	63.9
2011/2012	114	3,477	93,064	7,265	816.4	26.8	12.8	63.7
2012/2013	113	3,459	89,884	7,391	795.4	26.0	12.2	65.4
2013/2014	113	3,455	86,418	7,322	764.8	25.0	11.8	64.8

2014/2015	116	3,474	83,522	7,402	720.0	24.0	11.3	63.8
2015/2016	117	3,497	80,295	7,341	686.3	23.0	10.9	62.7
2016/2017	132	3,533	76,394	7,420	578.7	21.6	10.3	56.2
2017/2018	131	3,482	71,458	7,445	545.5	20.5	9.6	56.8

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

Tabela vijuese ofron të dhëna mbi arsimin e mesëm të ndarë nëpër rajone planore. Nga tabela mund të vërehet se numër më të madh të shkollave të mesme ka rajoni i Shkupit (36 shkolla), i pasuar nga rajoni i Pellagonisë (20 shkolla) dhe rajoni i Pollogut (18 shkolla). Sa i përket numrit të paraleleve listës i prinë rajoni i Shkupit me gjithsej 1,045 paralele, i pasuar nga rajoni Pollogut me 590 dhe rajoni Pellagonisë me 405 paralele. Sa i përket numrit të nxënësve të regjistruar në të gjitha klasat e ciklit të mesëm, siç pritet i prinë rajoni i Shkupit me gjithsej 24,260 nxënës, i pasuar nga rajoni Pollogut me 11,032 nxënës dhe rajoni i Pellagonisë me 8,052 nxënës. Numër më të madh të mësuesve të punësuar ka rajoni i Shkupit (2,253 mësues), i pasuar nga rajoni Pollogut (1,346 mësues) dhe rajoni Pellagonisë (846 mësues).

Nëse analizojmë mesataren e indikatorëve, gjegjësisht raportin e numrit të nxënësve, numrit të shkollave dhe numrit të mësuesve, do të kemi rezultatet si vijon:

- **Raporti Nxënës/Mësues**

Raport më të vogël nxënës/mësues ka rajoni Lindor me 8.1, i pasuar nga Pollogu me 8.2, rajoni Jug-Perëndimor me 8.4, rajoni Pellagonisë me 9.5, rajoni i Vardarit me 9.8, rajoni Jug-Lindor me 10.4, rajoni i Shkupit me 10.8, dhe rajoni Veri-Lindor me 11 nxënës për një mësues

- **Raporti Nxënës/Shkollë**

Raport më të ulët nxënës/shkollë ka rajoni Pellagonisë me 402.6 i pasuar nga rajoni Lindor me 403.8, rajoni Vardarit me 425.8, rajoni Jug-Perëndimor me 472.9, rajoni Jug-Lindor me 535.6, rajoni Pollogut me 612.9, rajoni i Shkupit me 673.9 dhe rajoni Veri-Lindor me 704 nxënës për një shkollë.

- **Raporti Mësues/Shkollë**

Raport më të lartë mësues/shkollë, gjegjësisht numër më të madh të mësuesve të punësuar për një shkollë ka rajoni Pollogut me 74.8 mësues për një shkollë, i pasuar nga rajoni Veri-Lindor me 63.9 mësues, rajoni i Shkupit me 62.6 mësues, rajoni Jug-Perëndimor me 56.1, rajoni Jug-Lindor me 51.7, rajoni Lindor me 49.9, rajoni Vardarit me 43.3 dhe së fundmi rajoni i Pellagonisë me një raport prej 42.3 mësues për një shkollë.

Tabela 6 - Shkollat e rregullta të mesme, klasat, nxënësit dhe mësuesit, sipas rajoneve – viti shkollor 2017-2018

	Shkolla	Paralele	Nxënë		Mësues					
			Gjithsej	Nxënëse femra	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Gjithsej	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Gjithsej	131	3,482	71,458	34,059	7,445	4,488	6,382	3,819	1,063	669
Rajoni Vardarit	11	242	4,684	2,138	476	278	416	245	60	33
Rajoni Lindor	14	286	5,653	2,801	698	395	595	329	103	66
Rajoni Jug-Perëndimor	14	367	6,621	3,258	786	436	665	364	121	72
Rajoni Jug-Lindor	9	246	4,820	2,332	465	278	413	245	52	33
Rajoni Pellagonisë	20	405	8,052	3,827	846	547	708	458	138	89
Rajoni Pollogut	18	590	11,032	5,026	1,346	709	1,201	633	145	76
Rajoni Veri-Lindor	9	301	6,336	3,161	575	327	528	293	47	34
Rajoni I Shkupit	36	1,045	24,260	11,516	2,253	1,518	1,856	1,252	397	266

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

3.2. ANALIZA E INDIKATORËVE MBI ARSIMIN NË NIVEL KOMUNAL – KOMUNA E GOSTIVARIT

Enti shtetëror i statistikave ofron të dhëna statistikore rreth arsimit edhe në nivel të komunave andaj në këtë pjesë do të analizohen disa indikatorë në nivek të komunës së Gostivarit, të cilën e kemi edhe si rast studimi në këtë punim të masterit.

Nëse shikojmë tabelën e mëposhtme do mund të shikojmë se sa i përket arsimit fillor gjatë periudhës 11 vjeçare (për të cilën disponohen të dhënat), pra nga viti 2007-2008 deri në vitin 2017-2018, siç ishte rasti në nivel shtetëror poashtu edhe në nivel lokal kemi ndryshime dhe trende jo të mira.

Tek dy indikatorët, numri i shkollave fillore dhe numri i paraleleve nuk kemi ndonjë lëvizje të theksuar siç edhe pritet. Shqetësues është fakti kur bëhet fjalë për numrin e nxënësve të regjistruar. Të dhënat e ofrura nga tabela vijuese tregojnë një trend shqetësues edhe në nivel lokal. Nëse në vitin shkollor 2007-2008, në Gostivar në të gjitha shkollat fillore janë regjistruar gjithsej 9,365 në vitin shkollor 2017-2018 ky numër ka arritur në 6,542. Në 11 vjeçarin e analizuar rezulton që kemi ulje të numrit të nxënësve të regjistruar për 2,823 nxënës apo 30.15% që paraqet një ulje shumë të madhe.

Nga ana tjetër sa i përket numrit të mësuesve në marrëdhënie pune, përgjatë periudhës së analizuar vërehet se kemi rritje të numrit të mësuesve të punësuar, ku në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur 637 mësues në shkollat fillore në Gostivar ndërsa në vitin shkollor 2017-2018 ky numër ka arritur në 708 pra në total kemi 71 mësues më shumë edhe përkundër faktit se kemi më pak nxënës.

Tabela 7 - Shkollat e rregullta fillore, klasat, nxënësit dhe mësuesit në komunën e Gostivarit

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve		Numri i mësuesve					
			Gjithsej	Nxënëse femra	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Femra	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2007/2008	29	451	9,365	4,490	637	324	626	316	11	8
2008/2009	29	455	8,558	4,057	645	337	632	331	13	6
2009/2010	29	457	8,384	4,051	646	348	628	337	18	11
2010/2011	29	458	7,727	3,702	663	371	645	358	18	13
2011/2012	29	453	7,437	3,566	671	389	651	378	20	11
2012/2013	29	455	7,083	3,356	672	403	646	387	26	16
2013/2014	29	450	6,735	3,206	681	424	650	407	31	17
2014/2015	28	474	6,809	3,260	703	451	668	434	35	17
2015/2016	29	454	6,449	3,034	668	432	647	410	41	22
2016/2017	29	456	6,592	3,160	681	438	639	413	42	25
2017/2018	29	459	6,542	3,091	708	452	626	402	82	50

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

Sa i përket shkollimit të mesëm në nivel të Gostivarit, mund të vërejmë të njëjtin trend sikur në nivel qendror. Numri i shkollave është rritur për 2 në 11 vjeçarin e analizuar, ku poashtu është rritur edhe numri i paraleleve, nga 179 paralele në vitin shkollor 2007-2008, në 192 paralele në vitin shkollor 2017-2018.

Ajo që është shqetësuese është fakti se kemi rënie në numrin e nxënësve të regjistura në të gjitha klasat. Nëse në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 5,060 nxënës në shkollat e mesme në Gostivar, në vitin shkollor 2017-2018 ky numër ka rënë në 3,365 nxënës. Pra, për periudhën 11 vjeçare për të cilat ka të dhëna zyrtare rezulton një rënie prej 1,695

nxënës apo 33.5% kemi më pak nxënës në shkollat e mesme se sa që kemi pasur në vitin shkollor 2007-2008.

Nga ana tjetër, kemi rritje të numrit të mësuesve të punësuar përgjatë kësaj periudhe, ku në vitin shkollor 2007-2008 kemi pasur gjithsej 370 mësues të punësuar (359 me orar të plotë dhe 11 me gjysëm orar), në vitin shkollor 2017-2018 kemi 424 mësues të punësuar (373 me orar të plotë dhe 51 me orar të shkurtuar). Në këtë rast, nëse në vitin shkollor 2007-2008 raporti nxënës/mësues ka qenë 13.7 nxënës për një mësues, në vitin shkollor 2017-2018 ky raport është afërsisht 8 nxënës për një mësues.

Tabela 9 - Shkollat e rregullta të mesme, klasat, nxënësit dhe mësuesit në komunën e Gostivarit

Viti shkollor	Numri i shkollave	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve		Numri i mësuesve					
			Gjithsej	Nxënëse femra	Gjithsej		Me orar të plotë		Me orar të shkurtuar	
					Gjithsej	Femra	Gjithsej		Femra	
							Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2007/2008	5	179	5,060	2,279	370	165	359	161	11	4
2008/2009	5	187	5,350	2,439	390	182	377	174	13	8
2009/2010	5	192	5,472	2,520	406	198	393	193	13	5
2010/2011	5	201	5,465	2,670	475	219	454	209	21	10
2011/2012	5	197	5,292	2,620	473	216	457	209	16	7
2012/2013	5	193	4 844	2,215	457	207	439	202	18	5
2013/2014	5	192	4 615	2 139	457	209	441	205	16	4
2014/2015	5	193	4,467	1,984	502	252	471	238	31	14
2015/2016	5	192	3,766	1,681	407	218	350	199	57	19
2016/2017	6	192	3,567	1,602	408	212	360	196	48	16
2017/2018	7	195	3,365	1,526	424	222	373	201	51	21

Burimi: Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008 deri në vitin 2017-2018

KAPITULLI IV - SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA INTERVISTAT DHE ANKETA E REALIZUAR ME QYTETARË - NË RAJONIN E GOSTIVARIT

Dizajni i hulumtimit vjen nga konceptet kryesore të përshkruara më lartë dhe presupozimet e adaptuara për këtë studim, duke u bazuar në ekzaminimin ekstenziv të literaturës. Më poshtë i përshkruajmë hipotezat mbi të cilat është bayuar kështu hulumtim dhe pyetjet e hulumtimit dhe si ato janë eksploruar në këtë studim.

1. Hipoteza e parë - Lufta e brendëshme për pushtet ka ndikuar negativisht në procesin arsimor në përgjithësi, dhe në procesin e reformimit të këtij dikasteri në veçanti.

2. Hipoteza gjenerale - Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në strukturat euro-atlantike do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së arsimit, duke pasur parasysh harmonizimin e legjislatujrës me atë të Bashkimit Evropian.

Hulumtimin tonë më të gjerë për ndikimi i politikës në arsim në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilën ishin kyçur 110 personave me karakteristika të ndryshme demografike si dhe profilin profesional, parashirova edhe gjashtëmbëdhjetë pyetje për ndikimin e politikës mbi arsimin, përshkak të kompleksitetit të temës, pyetjet ishin në llojë të mbyllur ku të anketuarit mund të zgjidhnin nga alternativat e ofruara, për këtë arsye do të përdoren teknika ndihmëse siç janë


1. historike – përshkruese,
2. komparative
3. analiza e dokumentacionit
4. anketat dhe intervistat

Duke i përdorur këto metoda do të sigurohet mundësia për përpunimin e punimit në baza shkencore. Tabela vijuese ofron një pasqyrë statistikore të, nga ku mund të vërejmë mesataren e përgjigjeve të dhëna si dhe devijimin standard, i cili tek të gjitha pyetjet nuk ka zhvendosje të theksuar.

Statistika deskriptive					
	N	Min	Max	Mesa tarja	Dev. Stard.
1. Sa jeni të kënaqur me reformat në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit?	110	1.0	4.0	2.964	.8875
2. A mendoni se reformat në arsim janë realizuar në mënyrën e duhur, duke siguruar trajnime paraprake dhe pajisje të mirëfilltë me materiale për procesin edukativo arsimor?	110	1.0	4.0	2.418	.6264
3. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë?	110	1.0	4.0	2.482	.7509
4. Kush përfshihet në emërtimin e drejtorëve të ri të shkollave?	110	1.0	4.0	3.591	.8048
5. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë e duhur?	110	1.0	4.0	2.764	.7285
6. A keni informatë se kush përfshihet në shkarkimin e drejtorëve të shkollave?	110	1.0	5.0	4.364	1.4509
7. Kush përfshihet në largimin e mësuesve nga puna në procesin edukativo arsimor në afat të caktuar kohor të shkollës?	110	1.0	5.0	2.664	.9314
8. Kush përfshihet në emërtimin e profesorëve të ri të shkollës?	110	1.0	5.0	2.855	.9171
9. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi?	110	1.0	3.0	1.509	.6873
10. A mendoni se mësimit trajtohen në mënyrën e duhur në shoqëri?	110	1.0	4.0	2.391	.7910
11. A mendoni se Këshilli i shkollës është i pavarur në vendimarrjes?	110	1.0	3.0	2.045	.4956
12. Si është cilësia e testeve shkollore?	110	1.0	3.0	1.791	.9197
13. Si e vlersojnë prindërit dhe nxënësit tekstet shkollore?	110	1.0	3.0	2.336	.7696
14. A mendoni se politika vendore ka ndikim në cilësinë e arsimit në RMV?	110	1.0	2.0	1.082	.2753
15. A mendoni se anëtarësimi i RMV në BE do ta depolitizoj arsimin?	110	1.0	3.0	1.664	.8381
16. Profili juaj si mësimit në anketë:	110	1.0	4.0	1.755	1.0509

Pyetja e parë e pyetësorit kishte të bëjë me faktin se sa të anketuarit janë të kënaqur me reformat në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit, ku nga figura e mëposhtme mund të vërehet se:

- 38.18% e të anketuarve apo 42 persona theksuan se janë pak të kënaqur
- 31.82% e të anketuarve apo 35 persona theksuan se aspak nuk janë të kënaqur
- 24.55% e të anketuarve apo 27 persona theksuan se pjesërisht janë të kënaqur dhe
- 5.45% e të anketuarve apo 6 persona theksuan se janë shumë të kënaqur.




Pyetja e dytë kërkonte nga i anketuari të vlerësoj se sa reformat në arsim janë realizuar në mënyrën e duhur, përmes sigurimit të trajnimeve paraprake dhe duke siguruar pajisje të mirëfillat me materiale për këtë proces, nga ku të anketuarit u shprehën si në vijim:

- 49.09% apo 54 të anketuar u deklaruan se reformat janë realizuar pjesërisht ashtu siç duhet
- 43.64% apo 48 të anketuar theksuan se ato nuk janë realizuar aspak si duhet
- 5.45% apo 6 të anketuar theksuan se janë realizuar në mënyrën e duhur dhe
- 1.82% apo 2 të anketuar u përgjigjen se nuk dinin.

Figura 2 – Realizimi i reformave në arsim


2. A mendoni se reformat në arsim janë realizuar në mënyrën e duhur, duke siguruar trajnime paraprake dhe pajisje të mirëfilltë me materiale për procesin edukativo arsimor?



Pyetja e tretë e rradhës i dedikoj strategjisë së arsimit dhe sa ajo është implementuar nga ana e qeverisë, nga ku fituam këto rezultate: më shumë se gjysma e të anketuarve gjegjësisht 56.36% theksuan se strategjia është implemetuar pjesërisht, 28.18% (31 të anketuar) theksuan se ajo aspak nuk është implementuar, vetëm 3.64% (4 të anketuar) theksuan se strategjia e arsimit është implementuar plotësisht nga qeveria, 11.82% (13 të anketuar) theksuan se nuk kanë njohuri.


Figura 3 – Implementimi I strategjisë së arsimit

3. Sa mendoni se është implementuar strategjia e arsimit nga ana e qeverisë?



Në pyetjen e rradhës(pyetja e katërtë) që kishte të bëjë me atë se kush në fakt bën emërimin e drejtorëve të shkollave, na u konstatua edhe “sekreti publik”, që në fakt dihet edhe në shoqëri, ajo se politika dhe pushteti janë ato që emërtojnë drejtorët e shkollave dhe këtë gjë e konfirmuan 81 prej të anketuarve që përbënin 73.64%. Vetëm 17.27% (19 të anketuar) mendonin se drejtorët emërohen nga këshilli i shkollës, 5.45% (6 të anketuar) se kjo gjë bëhet nga komision i veçantë i formuar enkas për këtë gjë, dhe vetëm 3.64% (4 të anketuar) se emërimi i drejtorëve bëhet nga këshilli i profesorëve.


Figura 4 – Emërtimi i drejtorëve



Pyetja e pestë me rradhë ishte e ndërlidhur me pyetjen paraprake dhe u kërkuar nga të anketuarit që të vlerësojnë se nëse përzgjedhja e drejtorëve bëhet në mënyrën e duhur, nga ku të anketuarit u përgjigjen përafërsisht sikur pyetja paraprake, gjegjësisht: 60.91% (67 të anketuar) theksuan se përzgjedhja e drejtorëve nuk bëhet në mënyrën e duhur, 21.82% (24 të anketuarve) theksuan se përzgjedhja bëhet pjesërisht në mënyrën e duhur, 6.36% (7 të anketuar) theksun se përzgjedhja bëhet në mënyrën e duhur ndërsa afërsisht 11% e të anketuar u shprehën se nuk dinë.

Figura 5 – Përzgjedhja e drejtorëve


5. A mendoni se përzgjedhja e drejtorëve të shkollave bëhet në mënyrë e duhur?



Pyetja e gjashtë e rradhës që iu parashtua të anketuarve kishte të bëj me atë nëse ato kanë informata se kush përfshihet në shkarkimin e drejtorëve të shkollave. Siç edhe mund të pritej, shumica dërmuese e të anketuarve apo 83.64% e të anketuarve theksuan se politika vendore është ajo që përfshihet në shkarkimin e drejtorëve të shkollave, gjë që është edhe realitet. Nga ana tjetër vetëm rreth 15% e të anketuarve theksuan se këshilli i shkollës është ai që përfshihet në shkarkimin e drejtorëve ndërsa vetëm afërsisht 2% theksuan se në shkarkimin e drejtorëve përfshihet këshilli i profesorëve.


Figura 6 – Shkarkimi i drejtorëve

6. A keni informatë se kush përfshihet në shkarkimin e drejtorëve të shkollave?




Lidhur me atë se kush përfshihet në largimin e mësuesve nga puna në procesin edukativo-arsimor të cilët janë me afat të caktuar kohor të angazhuar, e cila ishte pyetja e radhës, u morrën këto rezultate ku përsëri vërehet tendenca e pyetjeve paraprake, gjegjësisht fakti se politika dhe pushteti përfshihet edhe në këtë aspekt, pra në largimin e mësuesve nga puna në procesin edukativo arsimor që janë me afat të caktuar kohor. Këtë gjë e pohuan 68.18% (75) e të anketuarve, ndërsa 19.09% (21) pohuan se kjo gjë bëhet nga drejtori, 5.45% (6) theksuan se përfshihet Këshilli i shkollës dhe vetën 4.55% (5) theksuan se në këto raste përfshihet Këshilli i profesorëve. Vetëm 2.73% (3) e të anketuarve theksuan se nuk dinë.

Figura 7 – Përfshirja në largimin e mësuesve nga puna



Pyetja e tetë e pyetësorit kishte të bëj me atë se kush përfshihet në emërtimin e profesorëve të ri në shkollat. Përsëri, shumica e të anketuarve, 68.09% (76) e të anketuarve theksuan se politika dhe pushteti përfshihen në emërtimin e profesorëve të ri në shkollat, rreth 13.64% (15) theksuan se në këto raste përfshihet drejtori, 8.18% (9) theksuan se përfshihet Këshilli i profesorëve ndërsa vetëm 4.55% (5) theksuan se përfshihet Këshilli i shkollës. Afërsisht 5% (5) theksuan se nuk dinë si të përgjigjen.


Figura 8 – Përfshirja në emërtimin e profesorëve të ri



Pyetja e nëntë e pyetësorit kishte të bëj se sa rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës ndikojnë në kualitetin e arsimit, nga ku të anketuarit u shprehën si vijon: 60% e të anketuarve (68) theksuan se këto ndikojnë shumë, 29.09% (32) theksuan se ndikojnë pjesërisht, 10% (11) u shprehën se kjo nuk ndikon aspak.

Figura 9 – Ndikimi i rrogës dhe kushteve të punës në kualitetin e arsimit


9. Sa mendoni se ndikon rroga e mësimdhënësit dhe kushtet e punës në kualitetin e arsimit në përgjithësi?



Në pyetjen e radhës nga të anketuarit u kërkua që të japin mendimin rreth asaj se a trajtohen mësimdhënësit në mënyrë të duhur në shoqëri, ku të anketuarit u shprehë si vijon:

- 15.45% apo 17 të anketuar u shprehën se trajtohen në mënyrë të duhur
- 33.64% apo 37 të anketuar u shprehën se pjesërisht trajtohen në mënyrën e duhur
- 47.27% apo 52 të anketuar u shprehën nuk trajohen në mënyrën e duhur dhe
- 3.64 apo 4 të anketur theksuan se nuk e dinë gjegjësisht nuk kanë njohuri.


Figura 10 – Trajtimi i mësimdhënëseve



Pyetja vijuese e pyetësorit kishte të bëj me atë nëse Këshilli i shkollës është i pavarur në vendimarrjes, ku u morrën këto përgjigje:


- 10% apo 11 të anketuar theksuan se Këshilli i shkollës është i pavarur në punën e tij
- 75.45% apo 83 të anketuar theksuan se Këshilli i shkollës nuk është i pavarur
- 14.55% apo 16 të anketuar theksuan se nuk dinë

Figura 11 – Pavarësia e Këshillit të shkollës në vendimarrje




Pyetja tjetër vijuese kishte të bëj me atë se sa cilësor janë tekstet shkollore, ku nga përgjigjet e dhëna rezulton që: mbi gjysma apo 55.45% e të anketuarve theksuan se ato janë deri diku në rregull, 33.64% apo 37 të anketuar theksuan se janë të vështirë për tu kuptuar ndërsa vetëm 11.82% apo 13 të anketuar theksuan se nuk janë as të thjeshtë as të vështirë për tu kuptuar.

Figura 12 – Cilësia e teksteve shkollore



Pyetja vijuese kishte të bëj me atë se si prindërit dhe nxënësit vlerësojnë tekstet shkollore, dhe nga ku u dhanë këto përgjigje: mbi gjysma (51.82%) theksuan se deridiku janë në rregull, 30% theksuan se janë të dobta dhe 18.18% theksuan se janë shumë të dobët.

Figura 13 – Cilësia e teksteve shkollore sipas prindërve dhe nxënësve



Pyetja vijuese që iu drejtua të anketuarve ishte ajo nëse politika vendore ka ndikim në cilësinë e arsimit në RMV, nga ku të anketuarit në shumicë absolute prej 91.82% theksuan se politika në RMV ka ndikim në cilësinë e arsimit dhe se shkak i cilësisë së ulët pikërisht adresohet tek politika vendore. Vetëm 8% e të anketuarve mohuan një gjë të tillë.


Figura 14 – Politika vendore dhe ndikimi në cilësinë e arsimit



Pyetja e parafundit e pyetësorit kishte të bëjë me atë nëse RMV me anëtarësimin në BE do arrijë të depolitizojë arsimin, nga ku u fituan këto përgjigje:


- 57.27% apo 63 të anketuar pohuan këtë konstatim
- 19.09% apo 21 të anketuar mohuan këtë konstatim
- 23.64% apo 26 të anketuar nuk ishin të sigurtë.

Figura 15 – Depolizimi dhe anëtarësimi në BE



Së fundmi, nga të anketuarit u kërkua që të shpalosin profilin e tyre. Nga gjithsej të anketuarit 56.36% (62) ishin mësues, 25.45% (28) ishin prindër, 13.64% (15) njohës të rrethanave në arsim, dhe 4.55% (5) nxënës.

Figura 16 – Profili juaj në anketë



KONKLUZAT

Arsimi është njëra nga pikat më të rëndësishme të zhvillimit të një shoqërie bashkëkohore. Ngjarjet e ndryshme politike, konfrontimet pozitive – opozitive, vështirësitë dhe sfidat nëpër të cilat kalon shteti kanë lënë gjurmë të madhe në sferën e arsimit, duke lënë pasoja afatgjate në zhvillimin dhe edukimin e rinisë në vend.

Së pari, përpos konsensusit të gjerë të nevojës për cilësi në arsim, thellësia e saj dhe diapazoni dukshëm dallohen edhe sipas vendeve dhe sipas regjioneve. Madje ka dallime edhe në identifikimin e bazave të cilësisë.

Së dyti, qëllimi prioritar i arsimit tonë është sigurimi i cilësisë, qëndrueshmëria e saj dhe mos të harrojmë të mësojmë për të ditur, ta përkrahim cilësinë e cila sot dominon në botë.

Së treti, cilësia në arsim duhet të paraqes prioritet reformues në arsim, ndërsa cilësia e cila fillon nga mësonjëtorja kërkon përkush – tim, me atë nuk bëhet negociata dhe ajo kërkon një rol më përgje – gjës të arsimtarëve.

Së katërti, të gjitha institucionet dhe individët të cilët janë në mbrojtje të cilësisë në arsim duhet të jenë më rigoroz ndaj cilësisë, dhe të krijojnë strategji të reja dhe qasje për të kontribuar në cilësi e arsimit, sfidë për nxënësit dhe mësuesit mënyrë objektive në vlerësimin e cilësisë së arritur. Prandaj duhen instrumente të sakta, precize për ta matur peshën e cilësisë.

Së pesti, dituritë vlerësohen në cilësi, kohë dhe hapësirë. Së këndejmi paraqiten edhe diferenca të rëndësishme në objektivitet dhe qëndrueshmëri. Arsimi formal paguhet dhe administrohet gati plotësisht nga qeveritë ose nga organizatat jofitimprurëse. Kjo situatë është zhvilluar gradualisht dhe tashmë merret aq shumë për e mirëqenë sa edhe vëmendja më e vogël e qartë nuk drejtohet më tek arsyet e trajtimit të veçantë të shkollimit edhe në vendet në të cilat mbizotëron ndërmarrja e lirë si organizim dhe filozofi. Si rezultat të gjithë kësaj kemi një zgjerim të madh të përgjegjësisë të qeverisë. Në terma të parimeve të zhvilluara në kapitullin 2, ndërhyrja qeveritare në arsim mund të racionalizohet mbi dy themele. I pari është ekzistenca e “efektit substancial të lagjes”, rrethanave në të cilat veprimi i një individi imponon kosto domethënëse mbi individë të tjerë për të cilët nuk është fizibël ta bësh atë të kompensojë ata, ose prodhon fitime domethënëse për individë të tjerë për të cilët nuk është fizibël t’i bësh ata

të kompensojnë ato rrethana që e bëjnë shkëmbimin vullnetar të pamundur. I dyti është shqetësimi paternalist për fëmijët dhe individë të tjerë të papërgjegjshëm. Efektet e lagjes dhe paternalizmi kanë implikime shumë të ndryshme për 1. Arsimin e përgjithshëm për qytetari dhe 2. arsimin e specializuar vokacional. Arsytet për ndërhyrjen e qeverisë janë gjerësisht të ndryshme në këto dy fusha dhe justifikojnë tipa shumë të ndryshëm veprimi. Një shënim paraprak i mëtejshëm: është e rëndësishme të dallojmë midis “shkollimit” dhe “edukimit”. Jo çdo shkollim është arsim (education) dhe jo çdo arsim është shkollim. Subjekti i shqetësimit është arsimi. Veprimet e qeverisë janë më së shumti të kufizuara te shkollimi.

Misioni i shkollave ndryshon varësisht konteksteve kohore dhe rrethanave politike . Vetëm elitat kulturore dhe politike të një populli (shoqërie) mund të ndërtojnë programe dhe platforma vizionare arsimore. Nuk mund të bëhet ndarje “e prerë” e Misionit të shkollës si vend për edukimin; për arsimimin; për emancipimin; apo për aftësimin e masave? Por, nuk është krejt e pamundur të konstatohet se Vizionin për arsimin e kanë dominuar herë disa komponentë e herë komponentë të tjerë.

Reformat në arsim janë të gabuara dhe të pazbatueshme në praktikë. Ne kemi paralajmëruar se reformat nuk kanë për qëllim përmirësimin e procesit arsimor, përkundrazi, kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të njerëzve të tjerë. Në programet mësimore për klasën e parë dhe të katërt, përmes njësive mësimore për vendin, nxënësit nxiten të mësojnë për një të lloj identiteti të një qytetari.

REKOMANDIMET

Në drejtim të konkluzave të dhëna, rekomandimet e mëposhtme sugjerohen në këtë drejtim:

1. Të sistematizohen nxënësit sipas aftësive dhe shkathtësive: qysh në shkollë fillore varësisht nga aftësitë dhe shkathtësitë që kanë të klasifikohen në drejtime dhe zanate, që të mos kemi hiperpro- dukcion të disa profileve, prej të cilëve 70% nuk janë në gjendje të kryejnë profesionin ashtu si duhet; e në anën tjetër, të kemi mun- gesë kuadrosh në disa profile dhe zanate, për të cilat kemi shumë nevojë. 36
2. Të shkarkohen mësimdhënësit dhe nxënësit nga disa detyrime dhe përgjegjësi që mbingarkojnë ata, megjithëkëtë gjithnjë duhet pasur parasysh që nuk duhet të tejkalohen caqet e shkarkimeve që të mos prodhojmë pastaj gjenerata përtacësh. Në këtë sferë duhet të bëhen më shumë përpjekje, analiza, parashikime dhe strategji të kolauduara, prandaj duhet të rishikohen ligji, rregulloret, planprog- ramet, metodat e punës, librat, të bëhet vlerësimi (evaluimi) real i brendshëm dhe i jashtëm, por të mos bëhet me dënime, siç ishte deri para pak kohe³⁷
3. Të motivohen nxënësit dhe mësimdhënësit, sepse për të arritur sukses në ngritjen profesionale, njeriu duhet të jetë i motivuar: a) të garantohet punësimi i rinisë, duke bashkëpunuar shkollat e mesme profesionale ose fakultetet me ndërmarrjet publike dhe të gjitha institucionet në vend, b) të rriten pagat e mësimdhënësve në të gjitha nivelet e arsimit.
4. Prindërit duhet të kujdesen më shumë për fëmijët e tyre. Rëndom, ne i gëzohemi vetëm rastit kur fëmija jonë regjistrohet në shkollë, në klasën e parë dhe nuk mungon edhe interesimi ynë për punën e tij deri sa të mësojë të shkruajë e të lexojë, ndërsa në klasat e mëvonshme interesimi ynë zvogëlohet ose shuhet krejtësisht. Prindërit merren vetëm me punët e përditshme të mbijetesës, ndërsa për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve nuk çajnë kokën. Fëmija duhet të jetë gjithnjë nën përkujdesjen e prindit: A shkon në shkollë?, Kur shkon e kur kthehet?, Çfarë sjelljesh e çfarë edukate ka? A lexon, çka e sa

lexon? A i bën detyrat? Si e kalon kohën e lirë? Kur zgjohet e kur fle? Sa kohë qëndron në internet? Çka shfrytëzon nga rrjeti i internetit?

5. Mësimdhënësit duhet të punojnë me përkushtim më të madh, me më shumë zell dhe me metoda ndërvepruese (interaktive). Në orët e gjuhës amtare të shmanget mësimi skollistik, të mos kërkohet nga nxënësit vetëm që të riprodhojnë atë që e dëgjojnë ose e lexojnë, por të kërkohet nga ta të flasin e të shkruajnë me një origjinalitet, stil dhe kreativitet. Mësimi i të gjitha lëndëve të vihet në funksionin e zbatimit praktik në jetën e përditshme. Nxënësit të nxiten që të lexojnë sa më shumë libra. Ata të motivohen të thonë atë që mendojnë (qoftë edhe gabimisht), duke mbështetur e argumentuar mendimin, të kuptojnë atë që kanë lexuar a dëgjuar si dhe të kenë qëndrim vlerësues e kritik ndaj tyre. Mësimdhënësi në vlerësimet që jep për nxënësit duhet të jetë i matur, i drejtë, jofyes.
6. Gjatë punësimeve nëpër shkolla të sundojë meritokracia dhe jo punësimet partiake.
7. Të bëhen inspektive sistematike dhe reale. Nuk ka nevojë të gjobiten mësimdhënësit, por t'u tërhiqet vërejtje, të bëhen këshillime dhe seminare (trajnime) për përmirësimin e mangësive të tyre, kurse ata që e kryejnë punën me sukses të shpërblehen.
8. Testimi shtetëror për të marrë vendimin si mësimdhënësi të jetë realisht i vlerësuar dhe jo vetëm formalisht.
9. Të formohen grupe punuese në kuadër të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për të hartuar strategji dhe ndarje të detyrave. Këto grupe punuese do ta kenë barrën më të madhe të planifikimit afatgjatë të të gjitha strategjive. Për këtë arsye, në këto grupe punuese duhet të angazhohen njerëzit më të suksesshëm në këtë fushë.

BIBLIOGRAFIA

- Jonuz Abdullai, Ndryshimet Sociale dhe Tranzicioni, Tetovë 2008
- Isak Adizes, Zotërimi i ndryshimeve, Shkup 1996
- Samuel Haungtington, Vala e tretë, Tiranë 2011
- Francis Fukujama, Ndërtimi i shtetit, Tiranë 2010
- Blerim Reka, Marrëdhëniet ndërkombëtare, Shkup 2016
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Vankovska, B, Sistemi politik, Shkup, Bomat Grafiks, 2007
- Lawrence C. Mayer, Politikat krahasuese, Tiranë 2003
- Geraint Parry, Elitat politike, Tiranë 2010
- Jonuz Abdullai, Politika dhe politikat publike, Tetovë 2010
- Eva Tafili, Tranzicioni politik në Evropën Qëndrore dhe Lindore, Tiranë 2008
- Majkell Rouzen, Mendimi politik, Tiranë 2007
- Muhamedin Kullashi, Mendimi politik modern, Prishtinë 2005
- Geert-Hinrich Ahrens, Diplomaci mbi tehun e thikës, Tiranë 2010
- Rejnholld Cipelius, Teoria e përgjithëshme për shtetin, Mynhen 2010
- Bejtush Gashi, Kriza politike, Prishtinë 2012
- Strategjia e arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2025
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2007-2008
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2008-2009
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2009-2010

- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2010-2011
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2011-2012
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2012-2013
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2013-2014
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2014-2015
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2015-2016
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2016-2017
- Enti i Statistikave, Raporti për shkollat fillore dhe të mesme në fillim të vitit shkollor, për vitet nga 2017-2018
- North Macedonia Country Report 2022. BTI Transformation Index (<https://bti-project.org/en/reports/country-report/MKD>)
- https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/content/national-reforms-school-education-42_en
- UNICEF. Review of Evaluation and Assessment in Education in North Macedonia. 2019.
- <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/9b99696c-en/index.html?itemId=/content/component/9b99696c-en>
- https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/north_macedonia_report_2020.pdf
- <https://www.mchamber.mk/default.aspx?mld=3&evid=37301&lng=1>
- Metodologjia e vleresimit të qeverisjes dhe ndikimi i saj në përfshirjen sociale në sektoret e arsimit dhe shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë, Janar 2011